

KAPSLLËKU GJATË  
SHTATZËNISË

# TRENDËT E MODËS

ÇFARË JANË  
D-DIMERËT

PËRFITIMET E  
SUMAKUT

BETTY

GJITHÇKA PËR IMUNITETIN ME  
**DR. MITOV**



# PROBIOKID IMMUNO®


## PROBIOKID IMMUNO®

е синбиотик, кој помага во воспоставувањето и одржувањето на природниот баланс на цревната микрофлора и придонесува во јакнењето на одбранбените способности на организмот.



Се препорачува кај секое дете за:

- јакнење на имунитетот и зачувување на општата добра состојба на организмот, а посебно кај децата со атописка конституција склони кон алергии,
- кај деца кои се склони кон чести инфекции,
- деца кои се движат во колективи (градинки) или често примаат антибиотици.



Пред употреба внимателно да се прочита упатството!  
За индикациите, ризикот од употреба и несаканите дејства на граничниот производ, консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.

ÇFARË JANË  
D-DIMERËT

04.



PSE ËSHTË E  
RËNDËSISHME  
VITAMINA D<sub>3</sub>?

08.



GJITHÇKA PËR IMUNITETIN  
ME DR.MITOV

10.



KAPSLLËKU GJATË  
SHTATZËNISË

16.



TRENDET E  
MODËS

22.



BOTA E BRENDSHME E  
FËMIJËVE TË TALENTUAR

24.



PËRSE MJEKU PYET PËR  
SËMUNDJET QË I KEMI  
NË FAMILJE?

26.



PËRFITIMET E  
SUMAKUT

28.



USHQIMI GJATË  
PANDEMISË ME  
COVID-19

30.



IMPRESUM

Shef i redaksisë: Esin Zekir | Redaktor i fotografiës: Lençe Naumovska | Redaktor artistik dhe grafik: Lençe Naumovska  
Bashkëpunetore: dr. Dragica Zendelovska | spec. dr. Natasha Naumoska | dipl. pharmacist Gabriela Kaçakoska-Naneska | dipl. pharmacist Gordana Trendovska Serafimovska | Frosina Fran Maja Milovançeva-Poposka | mr. dr. Simonida Kotlarova Poposka | mr. pharmacist Mirjana Lozankovska Tëminiq | prof. dr. Slagjana Angelkoska | Sanja Gjorgjeva | ass. dr. Biljana Todorova Botusi: Feniks Farma DOOEL Shkup, rr. "Jadrancka magistrala" nr. 31, 1000, Shkup | Redaktim teknik: Idea Lab DE D00 | Marketing: bettymkd@phoenixpharma.com.mk

Lektor dhe korrigues: Ivana Koceska | Përkthim: Ardit Zulfiu | Boton: EVROPA 92, rr. Krizhovska nr.52, 2300, Koçan | Fotografi: Depositphotos, nëse nuk shkruan ndryshe  
Ilustrime: Freepik, nëse nuk shkruan ndryshe | Tirazh: 24.000

Revista BETTY është një revistë falas mujore, e disponueshme për të gjitha bimborat që mbështesin BETTY konceptin e marketingut në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Të gjitha përmbytjet dhe reklamat e botuara në revistë janë vetëm nga karakteri informativ dhe në asnjë mënyrë nuk mund të zëvendosojnë vizitë të mykut ose farmacistit. Feniks Farma DOOEL Shkup (në tekshin e mëtejshme Botusi) nuk është përgjegjës për përbijetjen e teksteve të botuara, si dhe për përbijatja që reklamohen në revistë, duke perfshirë edhe gabinet osse mosverprimet e pagujlitta. Me publikimin e reklamave në revistë, personat juridikë që i reklamojnë produkte të tyre, deyrinist do të respektojnë dispozitat nga Udhëzimi për meryn e reklamimit nga ilaciqe dhe pajisje medicinale. Ligi për ilaqet dhe pajiset medicinale, si dhe akte të tjera ligjore, përkatese në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në këtë drejtim, botuesi i revistës përishtosh çdo përgjegjës për dëmet që mund të vijnë nga mosrespektimi i dispozitave të lartpërmendura nga personat juridikë, si dhe për çdo dëmit që vijnë nga përdorimi i përbijetjes që reklamimit të produkteve në revistë. Ndalohet përdorimi ose kopimi i përbijetjes se BETTY revistës përfshirë qellime, pa leje me shkrim të botuesit të revistës. Redaksa e BETTY Revistas nuk ka asnjë detyrim të ktheje në tekstet e marra, fotografët dhe posta interneti.

[www.betty.mk](http://www.betty.mk)



PËRMBAJTJE

# Çfarë janë D-dimerët?

Organizmi ynë ka një mekanizëm shumë të rëndësishëm mbrojtës nga humbja e tepërt e gjakut kur lëndohen enët e gjakut ose indet. Ky mekanizëm i quajtur hemostazë, lejon formimin e fijeve të proteinës së fibrinogenit, të cilat lidhen së bashku dhe formojnë një rrjet fibrinogeni (trombe). Ky rrjet, së bashku me trombocitet (plakëzat e gjakut), ndihmon në ruajtjen e mpiksjes së gjakut që formohet në vendin e lëndimit derisa të shërohet. Pasi zona të ketë kohë për t'u shëruar dhe trombi nuk është më i nevojshëm, trupi fillon procesin e kundërt apo fibrinolizën, gjegjësisht shpërberjen e trombit në copa të vogla, që të mund të mënjanohet nga qarkullimi i gjakut. Një nga produktet e fundit të shpërberjes së fibrinës, përkatesisht nga trombet e formuara është D-dimeri, i cili mund të matet në një mostër gjaku.

Përcaktimi i vlerës së D-dimerëve në gjak përdoret për të përcaktuar praninë e një trombi joadekuat. Ai është i rëndësishëm për përashtimin e rrezikut të trombozës së thellë të venave, embolizmit pulmonar dhe goditjes në tru. Prandaj, kur pacienti shfaq simptoma të tillë si dhimbje ose ndjeshmëri të këmbëve,ënjtje të këmbëve, edemë, ndryshim i ngjyrës së këmbëve, rekondicionohet të përcaktohet vlera e D-dimerëve në gjak. E njëjtë këshillohet edhe në rast të simptomave të embolizmit pulmonar, si gulçim i papritur, kollitje dhe dhimbje e kraharorit që lidhet me mushkëritë. Vlera e D-dimerëve, së bashku me testet e tjera, mund të ndihmojë në diagnostikimin e koagulimit intravaskular të shpërndarë (DIC). Kjo është një gjendje në të cilën aktivizohen faktorët e mpiksjes dhe formohen mpiksje të vogla të gjakut. Është një gjendje komplekse, ndonjëherë kërcënuese për jetën, që mund të paraqitet si pasojë e situatave të ndryshme, duke përfshirë disa procedura kirurgjikale, sepsën, kafshimet e gjarpërinje helmues, sëmundjet e mëlçisë, si dhe pas lindjes së fëmijës.

Ky test përdoret për të përcaktuar nëse nevojiten ekzaminime shtesë për të ndihmuar në diagnostikimin e sëmundjeve dhe çrrregullimeve që shkaktojnë hiperkoagulimin, domethënë një prirje për mpiksje të tepërt të gjakut. Vlerat referente të D-dimerëve ndryshojnë në masë të vogël midis laboratorëve dhe varen nga një numër faktorësh. Por vlerat normale të pranuara përgjithësisht janë nën 500 ng/ml ose 0.5 mg/L. Përqendrimet e D-dimerëve rriten te gratë e moshuara dhe shtatzëna, por edhe në rast të situatave të tjera ku ndodh aktivizimi i proceseve të koagulimit dhe fibrinolizës, siç janë operacionet, lëndimet, infeksionet, proceset inflamatore, kanceri etj. Nuk ka studime të mjaftueshme për testimin e D-dimerëve tek fëmijët. Ka disa metoda të ndryshme për përcaktimin e vlerës së D-dimerëve. Testet aktuale të D-dimerëve në përdorim, të cilat janë rezultate sasiore, bëhen domosdoshmërisht në laboratorë ku vlerësimi i rezultateve bëhet nga një specialist për biokimi mjekësore ose transfuziolog.



Mirjana Lozhankovska Terminić  
Specialiste e biokimisë mjekësore, mr. farm.  
Shefe e Genea Lab

**SYN**ErgY

www.synev.it.net 02/3225 843

ПРИРОДНИ ВИТАМИНИ

**FERROFECT®**  
FERROUS BISGlyCINATE COMPLEX  
• CONTAINS IRON, VITAMIN C, B6, B12,  
FOLIC ACID AND  
• SUPPORTS MICROGLIA AND  
RED BLOOD CELLS  
30 tablets  
Dietary Supplement

**BETA CAROTENE**  
BETA CAROTENE 10mg  
• HIGH IN CAROTENE &  
PREVENTS AGEING  
80 softgel capsules  
Dietary Supplement

**SHARK CARTILAGE**  
SHARK CARTILAGE 75mg  
• NATURAL FORMULA  
• PREVENTS AGEING &  
• STRONG ANTIOXIDANT  
60 capsules  
Dietary Supplement

**VOLURINE®**  
D-MANNOSE COMPLEX  
• NATURAL  
• HEALTHY Joints SUPPORT  
• CONTAINS CHONDROITIN SULFATE  
30 capsules  
Dietary Supplement

**VITAMIN B6** 50mg  
PYRIDOXINE HYDROCHLORIDE 50mg  
• NATURAL  
• VITAMIN B6  
80 capsules  
Dietary Supplement

**АКЦИЈА - 50%**

**FERROFECT**  
Брза и безбедна помош за крвната слика

**BETA CAROTENE**  
За подобар имунитет, кожа и вид

**SHARK CARTILAGE**  
Помалку болки и полесна подвижност на зглобовите

**VOLURINE**  
Стоп за Ешерихија Коли

**VITAMIN B6 50mg**  
За добро расположение и повеќе енергија

# Mbipesha nuk është vetëm një problem estetik por edhe një problem mjekësor

Mbipesha ose obeziteti është një sëmundje komplekse që karakterizohet nga sasitë e tepërtë të yndyrës në trupin e njeriut. Mbipesha nuk është vetëm problem estetik, por edhe problem mjekësor që rrit rrezikun e sëmundjeve dhe problemeve të tjera shëndetësore.

Mbipesha përcaktohet nga indeksi i masës trupore (BMI). Ky indeks fitohet duke pjesëtuar peshën e trupit të shprehur në kilogram me gjatësinë e trupit të shprehur në metra - për katror. Njerëzit me indeks të masës trupore më të ulët se  $18.5 \text{ kg/m}^2$  janë nënpeshë, nga  $18.5 - 24.9 \text{ kg/m}^2$  janë me peshë normale trupore, kurse njerëzit me BMI prej  $25.0 - 29.9 \text{ kg/m}^2$  janë mbipesë. Nga aspekti klinik, më së shumti duhet të shqetësohen personat me BMI prej  $30.0 - 34.9 \text{ kg/m}^2$  - klasa I e mbipesës,  $35.0 - 39.9 \text{ kg/m}^2$  klasa II e mbipesës dhe sidomos  $40 \text{ kg/m}^2$  dhe më lart, të cilët klasifikohen në klasën III të mbipesës ose obezitet morbid.

Ka një sërë arsyesh pse disa njerëz kanë vështirësi në shbangjen e mbipesës. Zakonisht është rezultat i faktorëve të lindur, të kombinuar me faktorët e mjedisit, dietat dhe mënyrat e të ushqyerit, ndonëse varet edhe nga aktiviteti fizik. Lajmi i mirë është se edhe humbja më e vogël në peshë mund të përmirësojë ose parandalojë problemet shëndetësore që paraqiten për shkak të mbipesës. Përveç faktorëve gjenetikë për mbipesën, ekziston edhe një ndikim metabolik dhe hormonal në peshën e trupit. Rritja e saj ndodh edhe kur merren më shumë kalori sesa trupi mund të harxhojë nëpërmjet aktivitetit fizik dhe aktiviteteve ditore. Në këtë rast trupi i depoziton kaloritë e tepërtë në yndyrë.

Një dietë e pasur me shumë kalori, si ushqimi i shpejtë dhe ushqimet me kalori të lartë ka shumë të ngjarë të çojnë në obezitet. Njerëzit obezë mund të hanë më shumë kalori para se të ndjehen të ngopur, i merr shpejt uria ose hanë më shumë si rezultat i stresit ose ankthit. Nga ana tjetër, faktorët gjenetikë mund të kenë ndikim në sasinë e yndyrnave që depozitohen në trup dhe shpërndarjen e tyre. Po aq të rëndësishme janë efektiviteti me të cilin trupi shndërron ushqimin në energji, mënyra se si trupi rregullon oreksin dhe mënyra se si i djeg kaloritë gjatë aktivitetit fizik.

Shpeshherë ndodh që obeziteti të jetë i pranishëm te më shumë anëtarë në familjen më të ngshtë. Kjo nuk vjen vetëm si pasojë e faktorëve gjenetikë, por edhe për shkak të zakoneve të ngashme të të ushqyerit dhe aktivitetit fizik. Dieta me shumë kalori, me pamjaftueshmëri të frutave dhe perimeve, përdorimi i ushqimit të shpejtë dhe ngrënia e porcioneve të mëdha, si dhe konsumimi i pijeve kalorike (alkoolike, të



gazuara) që nuk të ngopin, e gjithë kjo e kombinuar me pasivitet fizik dhe shumë orë të kaluara para ekranave, pa dyshim që çon në obezitet.

Obeziteti mund të paraqitet edhe në suaza të disa sëmundjeve endokrinologjike, probleme të tillë si artri, dhe kur përdoren disa ilaçë (ilaçet kundër depresionit, antiepileptikët, antipsikotikët, ilaçet e diabetit, kortikosteroidet dhe beta-bllokuesit). Në këtë mes nuk mund të lihen pa përmendur edhe faktorët socialë dhe ekonomikë, të cilët janë të lidhur ngshtë me obezitetin. Mungesa e financave për të siguruar ushqim të shëndetshëm dhe ekzistimi i njerëzve obezë në familje, me të cilët kalojnë më shumë kohë, mund të rrisin rrezikun e obezitetit.

Obeziteti mund të ndodhë në çdo moshë, madje edhe tek fëmijët e vegjël. Por me procesin e plakjes, ndryshimet hormonale dhe aktiviteti fizik i zgjeluar, rreziku i obezitetit rritet. Shtatzënia është një periudhë kur fitohet shumë peshë trupore. Të gjitha gratë shtatzëna duhet të këshillohen që të ushqehen shëndetshëm, të hanë një dietë të përshtatur nga ana sasiore dhe të harrojnë teorinë se në shtatzëni duhet të hahet për dy vjetë.

Kjo peshë trupore që fitohet mund të bëhet shkak për obezitetin më vonë në jetë, prandaj është mirë që çdo grua të humbasë kilogramët e tepërt të fituar gjatë ushqyerjes me gjë.



Obeziteti mund të ndodhë në çdo moshë, madje edhe tek fëmijët e vegjël. Por me procesin e plakjes, ndryshimet hormonale dhe aktiviteti fizik i zvogëluar, rreziku i obezitetit rritet. Shtatzënia është një periudhë kur fitohet shumë peshë trupore. Të gjitha gratë shtatzëna duhet të këshillohen që të ushqehen shëndetshëm, të hanë një dietë të përshtatur nga ana sasiore dhe të harrojnë teorinë se në shtatzëni duhet të hahet pér dy vetë. Kjo peshë trupore që fitohet mund të bëhet shkak pér obezitetin më vonë në jetë, prandaj është mirë që çdo grua të humbasë kilogramët e tepërt të fituar gjatë ushqyerjes me gjii.

Ndërprerja e pirjes së duhanit, me ç'rast cigaret zëvendësohen me ushqim, mund të bëhet shkaktar i obezitetit. Mungesa e gjumit ose gjumi i tepërt dhe situatat stresuese që shoqërohen me ngrënien të tepërt, sidomos ushqime me shumë kalori, po ashtu mund të çojnë në rritje të oreksit dhe obezitet. Është shumë e rëndësishme të theksohet efekti yo-yo, ku metabolizmi ngadalësitet dhe përpjekjet e mëparshme pér të humbur peshë pasohen nga fitimi i shpejtë në peshë trupore, që mund të çojë në fitim afatgjatë në peshë dhe obezitet.

Obeziteti ndryshon shumë cilësinë e jetës. Njerëzit obezë mund të ndihen "të diskriminuar". Këta njerëz shpesh vuajnë nga depresioni, problemet seksuale, izolimi shoqëror me një ndjenjë turpi dhe faji, kapaciteti më i ulët i punës etj.

Hapat pér të parandaluar fitimin në peshë trupore janë të njëjtë me ato të humbjes në peshë: aktiviteti fizik i përditshëm, një dietë e shëndetshme dhe kujdesi në përzgjedhjen e ushqimeve dhe pijeve që konsumohen çdo ditë. Aktiviteti fizik me intensitet mesatar (p.sh. ecja e shpejtë dhe noti), pér 150–300 minuta në javë, është shumë i dobishëm në parandalimin e

obezitetit. Për më tepër, këshillohet një dietë e shëndetshme, që synon ngrënien e ushqimeve me pak kalori, më shumë fruta, perime, drithëra dhe zvogëlimin e yndyrave të ngopura, sheqernave, alkoolit. Gjituashtu këshillohet që të hani tre vakte të shëndetshme në ditë, të shoqëruar me ngrënien të kufizuar të mesvakteve. Mos harroni të matni peshën një herë në javë!

Në përgjithësi, obeziteti duhet dhe mund të trajtohet. Këshillohen para së gjithash ndryshimet në stilin e jetës (të ushqyerit, rritja e aktivitetit fizik, ndryshimet në sjellje). Individët që kanë një BMI prej  $30\text{kg/m}^2$  ose më shumë, duhet të marrin parasysh marrjen e barnave pér dobësim. Në rastet kur indeksi BMI është më i lartë se  $27\text{ kg/m}^2$  dhe njerëzit kanë komplikime të lidhura me obezitetin, po ashtu duhet të merret parasysh trajtimi me barna pér dobësim.

Ekzistojnë edhe procedura kirurgjikale pér zvogëlimin e peshës që lejohen tek njerëzit me BMI prej  $30\text{ kg/m}^2$  dhe më shumë, kur dieta dhe aktiviteti fizik nuk rezultojnë në humbje peshe. Te njerëzit me obezitet morbid, me BMI  $40\text{ kg/m}^2$  dhe më shumë ose BMI prej  $35\text{--}39.9\text{ kg/m}^2$ , por të shoqëruar me probleme të tjera shëndetësore, mund të mendohet mundësia e ndërhyjes kirurgjike pér zvogëlimin e peshës.

Krahasuar me njerëzit me peshë normale të trupit, njerëzit obezë kanë rrezik nga 50% - 100% më të madh të vdekjes së parakohshme. Për këtë arsy, obeziteti duhet të identifikohet dhe të parandalohet në kohë, meqenëse trajtimi i tij është i mundimshëm dhe më shpesh kërkon një qasje multidisiplinore nga disa fusha të ekspertizës.



Dr. Biljana Todorova

KLINIKË E ENDOKRINOLOGJISË, DIABETIT DHE  
SËMUNDJEVE TË METABOLIZMIT, SHKUP



# КОЈ ВЕЛИ ДЕКА ДЕБЕЛИНАТА Е ХРОНИЧНО ЗАБОЛУВАЊЕ? ДОКТОРИТЕ.

Често дебелината се доживува како избор во начинот на живот. Сега, професионалните здруженија, како што е Светската Федерација за борба против дебелината, препознаваат дека дебелината е хронично заболување и не е резултат на лоши избори во начинот на живот.<sup>1-5</sup> Перцепцијата се менува со развојот на науката. Препознавањето на дебелината како хронично заболување може да направи вистинска разлика за лубето кои можеби никогаш не добиле соодветна грижа и поддршка при справување со нивната телесна тежина.<sup>1-5</sup>

**ДЕБЕЛИНА. ЦИКЛУСОТ НА ЗАБОЛУВАЊЕТО МОЖЕ ДА СЕ ПРЕКИНЕ.**  
[TRUTHABOUTWEIGHT.GLOBAL](http://TRUTHABOUTWEIGHT.GLOBAL)



1. Bray GA et al. *Obes Rev*. 2017;18:715–723. 2. AMA resolutions. Available at: [https://www.ama-assn.org/sites/ama-assn.org/files/corp/media-browser/public/hod/a12-resolutions\\_0.pdf](https://www.ama-assn.org/sites/ama-assn.org/files/corp/media-browser/public/hod/a12-resolutions_0.pdf). Пристапено во: ноември 2020. 3. Food and Drug Administration. Guidance for Industry Developing Products for Weight Management 2007. Available at: <https://www.fda.gov/media/71252/download>. Пристапено во: ноември 2020. 4. Obesity Canada. Available at: <https://obesitycanada.ca/obesity-in-Canada/>. Пристапено во: ноември 2020. 5. EASO: 2015 Milan Declaration: A Call to Action on Obesity. Available at: <https://cdn.easo.org/wp-content/uploads/2018/12/16195534/EASO-Milan-Declaration-FINAL.pdf>. Пристапено во: ноември 2020.

Ново Нордиск Фарма ДООЕЛ  
ул. Никола Кљусев бр. 11, Скопје, Р.С. Македонија  
тел: +389 2 2400 202; [www.novonordisk.com](http://www.novonordisk.com)  
D-33/01-11/2020

# Pse është e rëndësishme Vitamina D<sub>3</sub>?



Габриела Качакоска-Нанеска  
дипломиран фармацевт  
ПЗУ АПТЕКА БИОЛЕКЗ, ПРИЛЕП



## Roli i saj në të gjithë organizmin është shumë i rëndësishëm:

- Si një imunomodulator, ka ndikim të madh në mbrojtjen kundër sëmundjeve virale dhe bakteriale
- Eshtra të shëndetshme te të moshuarit, sepse siç u përmend, ajo merr pjesë në metabolismin e kalciumit dhe fosforit dhe kështu parandalon osteoporozën
- Është një element i rëndësishëm për fémijët dhe të sapolindurit, meqenëse mbron nga shfaqja e alergjive të ushqimit, rritja e presionit të gjakut, rreziku i astrmës.

Mungesa e Vitaminës D<sub>3</sub> është më e theksuar në periudhën e dimrit, sepse në këto muaj trupi nuk prodhon vetë vitaminë D dhe kjo për shkak të rrezeve të diellit që janë shumë të rralla dhe jo të mjaftueshme. Megjithatë, edhe në muajt e tjerë njerëzit nuk qëndrojnë mjaftueshëm në diell për shkak të orarit të punës ose për shkak të efekteve të dëmshme të rrezeve të diellit. Rrezik më të madh të mungesës së Vitaminës D<sub>3</sub> kanë njerëzit që jetojnë në rajonet veriore, njerëzit që jetojnë në vendet ku ka ndotje të lartë të ajrit dhe njerëzit me ngjyrë të errët të lëkurës.

Mungesa e Vitaminës D<sub>3</sub> çon në zbutjen e indeve të eshtrave, duke rezultuar në dobësi të muskujve dhe në masë të zvogëluar muskulore. Tek njerëzit e moshuar, mungesa e vitaminës D mund të jetë pikëniqe për osteoporozën. Këta individë mund të kenë lodhje, dhimbje në eshtra dhe muskuj etj.

## Përdorimi i saj është veçanërisht i rëndësishëm për:

- Eshtra të shëndetshme, sidomos tek të moshuarit në parandalimin dhe trajtimin e osteoporozës
- Përmirësimin e sistemit imunitar, duke zvogëluar rrezikun e sëmundjeve virale
- Lëkurë më të shëndetshme
- Dhëmbë të shëndetshëm
- Përqendrim më të mirë dhe rritje të energjisë

Vitamina D është një vitaminë liposoluble, gjegjësisht vitaminë që tretet në yndyrë. Këto vitamina ruhen në trupin e njeriut, duke krijuar rezerva, për dallim nga vitaminat hidrosolubile, të cilat janë të tretshme në ujë dhe tepica e tyre nxirret përmes urinës.

## Ekzistojnë dy forma të vitaminës D:

Vitamina D<sub>3</sub> (kolekalciferol) dhe Vitamina D<sub>2</sub> (ergokalciferol)

Ndryshe nga Vitamina D<sub>2</sub>, Vitamina D<sub>3</sub> është më efektive në rritjen e përqendrimit në formën e tij aktive në organizëm.

Burimet kryesore të Vitaminës D<sub>3</sub> (kolekalciferol) janë dielli, ushqimi dhe shtojcat ushqimore. Vitamina D<sub>3</sub> është e vërtmaja vitaminë D që trupi mund ta prodhojë dhe falë dritisë së diellit, sinteza e saj fillon në lëkurë. Është një element i rëndësishëm për metabolizmin e kalciumit dhe fosforit, duke lejuar përrithjen dhe ruajtjen e tyre në eshtra. Duke qenë se numri i njerëzve që shmanqin diellin sa vjen e shtohet, vitamina duhet medoemos të merret përmes shtojcave, për të përbushur kërkesat e organizmit për Vitaminën D<sub>3</sub>.

## Rekomandohet në rast të:

- Mungesës së vitaminës D
- Personat në rrezik të sëmundjeve infektive
- Personat me osteoporozë ose osteopeni
- Gratë në menopauzë
- Personat me sëmundje kardiovaskulare dhe diabet
- Personat me sëmundje malinje

Doza e rekomanduar është 400 - 800 IU ose 10 - 20 mikrogramë. Megjithatë, nëse ekspozimi në diell zvogëlohet ose mungon fare, atëherë doza e rekomanduar duhet të tejkalojë 1000 - 4000 IU (25 - 100 mikrogramë).

Që të shfrytëzohet sa më mirë nga organizmi, është mirë që Vitamina D<sub>3</sub> të merret me ushqime që janë të pasura me yndyma (mish, arra, etj.)

## Ushqime të pasura me Vitaminën D<sub>3</sub>:

- Salmoni
- E verdha e vezës
- Peshku ton
- Kërpudhat
- Sardelet

Për fat të keq, nuk mund të hamë peshk çdo ditë, ndaj burimi i vetëm i Vitaminës D<sub>3</sub> mbeten shtojcat ushqimore.



# БОЛКА ВО ГРЛО

д-р Александра Шотароска Тасевска, оториноларинголог

Болката во грло претставува непријатно чувство на гребење, сувост или жарење во грлото, кое уште повеќе се потенцира при голтање. Есенските и зимските месеци се период кога пациентите често бараат совет од лекар или фармацевт токму за овој проблем.

Грлото и носот се почетен дел од дишните патишта и се главна влезна врата за микроорганизми. Лимфните јазли на вратот и крајниците во грлото претставуваат прва одбрамбена линија.

Најчеста причина за појава на болка во грлото се **вирусни инфекции**, во 50 до 80% случаи. Најчести вируси кои предизвикуваат болка во грлото се аденоовириси, респираторни вируси, риновируси.

Околу 20% од воспаленијата на грлото се предизвикани од **бактерии (стапилококи и стрептококи)** и уште поретко причина може да биде габична инфекција (кандида) како резултат на нарушена флора во усната шуплина.

Други причини за појава на болка во грлото се од неинфекцијска природа: алергија, постназален исцедок, иритација од загаден воздух, сув воздух, пушење цигари, алкохол, ладни напитоци, рефлукс од желудник итн.

Многу често болката во грло е проследена со затнат нос, течење на носот и блага температура.

Во овој стадиум се препорачуваат **локални антисептици со аналгетско и противвоспалително дејство**, спреј за нос при отежнато дишење, како и топли напитоци, одмор и витамини. Најчесто симптомите со оваа терапија се повлекуваат за 3 до 5 дена.

## КОГА ДА СЕ ПОСЕТИ ЛЕКАР?

Во случај кога симптомите опстојуваат повеќе од 5 дена, температурата останува покачена, болката се засилува, се појавуваат беличести, гноjni наслаги на крајниците, оток во грлото, зголемени и болни лимфни јазли на вратот, болка во зглобовите, болка во уво, осип, тогаш се препорачува посета и консултација со матичен лекар или оториноларинголог.

## ВАЖНО ДА СЕ ЗАПАМТИ!

Воспалението на грло е најчесто предизвикано од вируси и антибиотиците во тој случај не помагаат. Не земајте антибиотици на своја рака! Лекувањето со антибиотици треба да се започне само во консултација со лекар.

## Септолете® ТОТАЛ

Твоето грло е твоја мок.

- Брзо ја намалува болката
- Го намалува воспалението
- Ги отстранува причините за инфекција



KRKA

Нашата иновативност и знаење  
создаваат ефикасни и сигури  
производи со највисок квалитет.

[www.septoletetotal.mk](http://www.septoletetotal.mk)

Пред употреба внимателно да се прочита упатството! За индикациите, ризикот од употребата и несаканите дејства на лекот консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.

# GJITHÇKA PËR IMUNITETIN ME dr.MITOV

*„Një nga armiqtë më të  
mëdhenj të sistemit imunitar  
është pikërisht stresi“*

Ajo që e dallon Dr. Aleksandër Mitovin është komunikimi i tij jo i përditshëm, kujdesi për patientët dhe përkushtimi maksimal ndaj ndjekësve të vet. Ai beson se mjekësia është e lidhur ngushtë me stilin e jetës së njeriut dhe thekson rëndësinë e shprehive të shëndetshme.



## Çfarë është imuniteti dhe pse është aq i rëndësishëm?

Mjedisi që na rrethon është i ndotur, kurse brendia jonë është e pastër dhe sterile. Kjo e nxit sistemin imunitar që të vihet në punë me të gjitha kapacitetet e veta. Pra, ne "notojmë" në një botë të baktereve dhe viruseve që dëshirojnë të depërtojnë në trupin tonë. Sistemi imunitar është ai që e mban trupin tonë të pastër dhe të mbrojtur. Në thelb, imuniteti ndahet në imunitet të lindur dhe të fituar, që do të thotë se sistemi imunitar mund të mësojë dhe të përshtatet. Mjafton që të çonjëri prej nesh të ketë kaq njoħuri si një hyrje në imunitetin e vet.

## Në cilat mënyra mund të mbështetim imunitetin?

Imuniteti është një nga funksionet e shumta të trupit tonë. Të gjitha funksionet, cila më shumë e cila më pak, varen nga mënyra e përgjithshme e jetesës. Prandaj, si hamë, sa aktivë jemi, sa pushojmë dhe sa flemë, a kemi stres - të gjithë këta janë faktorë me ndikim në funksionet e trupit tonë, duke përfshirë edhe imunitetin. Për këtë arsyе është e rëndësishme që të vendoset një baraspeshë gjithëpërfshirëse në stilin e jetës, nëse duam të mbështesim sistemin imunitar në mënyrën e duhur.

A është një dietë e shëndetshme e mjaftueshme për të përmirësuar imunitetin?

Ushqimi është ndoshta një nga faktorët më të rëndësishëm. Sistemi imunitar ka nevojë për elemente të domosdoshme ndërtuese, si dhe enzima dhe minerale, të cilat kanë një efekt kyç. Është e rëndësishme që të gjitha të merren rregullisht dhe në sasi të mjaftueshme. Por, sigurisht, pa faktorët e tjera që përmendëm, nuk mund të thuhet se dieta më vete është e mjaftueshme.

Cilat ushqime mund të na ndihmojnë më së shumti për të ndërtuar imunitet të fortë?

Ka produkte të ndryshme për të cilat studimet shkencore tregojnë njefarë efekti në sistemin imunitar dhe një gjë e tillë është shpresëdhënëse. Për shembull, kërpudhat mendohet se janë stimulues të sistemit imunitar. Besohet se sasitë e larta të beta-glukanëve të gjetur në kërpudha kontribuojnë në reagime më të mira të sistemit imunitar. Studiuesit i konsiderojnë edhe kivit të jenë stimulues të sistemit imunitar dhe ka rezultate

НОВО

ДИАСТОП

Дирекќи

## ЗА ВАШИТЕ СТОМАЧНИ ТЕГОБИ

Соодветен при:

- ▶ дијареја
- ▶ надуеност
- ▶ употреба на антибиотици
- ▶ инфекција предизвикана од *Helicobacter pylori*

9 милијарди пробиотски бактерии во една ќесичка + витамин D<sub>3</sub>

Придонесува за нормална работа на ензимите за варење на храната, за имуношпицот систем и за перисталтиката на цревата, како и за намалување на честотата и на сериозноста на благи до умерени дигестивни симптоми коишто настануваат поради нарушување на нормалната цревна микроолора.

ПЕРОРАЛЕН ПРАШОК  
ЗА ДИРЕКТНА УПОТРЕБА



БЕЗ ШЕЌЕР СО ВКУС НА ЈАГОДА И МАЛИНА



АЛАКАЛОНД  
СКОПЈЕ

Здравјето ти е

Предупотреба внимателно да се прочита упатството! За индикациите, ризикот од употребата и за несаканите дејства на граничниот производ, консултирајте се со Вашиот лекар или со фармацевт.

shpresëdhënëse në këtë drejtim. Megjithatë, kjo shkencë duket të jetë disi e re dhe kemi ende shumë për të hulumtuar në këtë fushë.

### Sa dhe si ndikon stresi në sistemin imunitar?

Një nga armiqtë më të mëdhenj të sistemit imunitar është pikërisht stresi. Lexuesit e kanë përjetuar edhe vetë, kur për shembull, pas situatave stresuese, mund t'u është shfaqur herpesi që më parë kishte qenë i fshehur. Herpesi, natyrisht, është vetëm një manifestim i lehtë kundrejt atyre që ndodhin në të vërtetë në sistemin tonë nën ndikim të stresit. Veçanërisht duhet të theksohet roli i të ashtuquajturit stres kronik, i cili në periudha më afatgjate dëmtion sistemin imunitar.

### Sa ndikon gjumi cilësor në shëndetin tonë?

Është pikërisht ky përbërës që anashkalohet më së shumti në jetën e njeriut bashkëkohor. Në fund të fundit, jemi të gjithë disi të zënë dhe shpeshherë e shfrytëzojmë kohën e gjumit për të bërë gjithçka përvëçse të flejmë. Ka të dhëna epidemiologjike që tregojë se ka një valë pagjumësie,



**ОИТОФАРМ**  
Инспирирани од здравјето!

РИБИНОВИТ

Рибино масло од црн дроб на бакалар

РИБИНО МАСЛО ОД ЦРН ДРОБ НА БАКАЛАР Е БОГАТ ИЗВОР НА:

- ВИТАМИН А
- ВИТАМИН Д
- НЕЗАСИТЕНИ ОМЕГА 3 МАСНИ КИСЕЛИНИ

СЕ ПРЕПОРАЧУВА ЗА:

- ДЕЦА ВО ФАЗА НА РАСТЕЊЕ
- ВОЗРАСНИ ПРИ НЕДОСТАТОК НА ВИТАМИНИ А И Д ВО ИСХРАНАТА.



#### ВИТАМИНОТ А ПРИДОНЕСУВА ЗА ПОДОБРУВАЊЕ НА:

- ВИДОТ,
- ФУНКЦИЈАТА НА ИМУНОЛОШКИОТ СИСТЕМ,
- МЕТАБОЛИЗАМОТ НА ЖЕЛЕЗОТО,
- СОСТОЈБАТА НА КОЖАТА И МУКОЗНИТЕ МЕМБРАНИ.

#### ВИТАМИНОТ Д ПРИДОНЕСУВА ЗА ПОДОБРУВАЊЕ И ОДРЖУВАЊЕ НА:

- АПСОРПЦИЈАТА (ИСКОРИСТУВАЊЕТО) НА КАЛЦИУМ И ФОСФОР,
- ФУНКЦИЈАТА НА МУСКУЛИТЕ,
- ПРАВИЛНА МИНЕРАЛИЗАЦИЈА НА КОСКИТЕ И ЗАБИТЕ,
- НОРМАЛНА КОНЦЕНТРАЦИЈА НА КАЛЦИУМ ВО КРВТА,
- НОРМАЛЕН РАСТ И РАЗВОЈ НА КОСКИТЕ КАЈ ДЕЦАТА.

veçanërisht në mesin e popullatës më të re. Është mirë të dihet se më pak se 4 orë gjumë në një natë të vetme fillon të ndikojë negativisht në sistemin imunitar. Pra merreni me mend nëse vazhdohet ashtu për një periudhë më të gjatë? Prandaj, i këshilloj lexuesit që ta marrin veçanërisht seriozisht këtë pjesë që ka të bëjë me lidhjen midis gjumit dhe imunitetit dhe të mos e kalojnë.

**Cilat janë rekomandimet tuaja për njerëzit që vuajnë nga sëmundje kronike?**

Sëmundjet kronike kërkojnë disiplinë. Disiplinë në të ushqyer, në aktivitet fizik, në terapi, ekzaminime të rregullta dhe shtesa të nevojshme ushqimore. Në këtë mënyrë, e gjithë gjendja mund të bëhet shumë më e lehtë dhe vetë sëmundjet të mbahen nën kontroll sa më shumë që të jetë e mundur. Gjithashtu, në këtë pandemi u rekomandoj që ta ruajnë veten, por edhe të mos kenë aq shumë frikë sa t'u krijojë probleme në jetën e përditshme. Virusi nuk është një dënim me vdekje, për askënd, qoftë i ri apo më i moshuar ose sido që të jetë gjendja e tij shëndetësore, është thjesht i paparashikueshëm. Të ruajnë shëndetin dhe të shijojnë festat!



ДОДАТОК ВО ИСХРАНАТА

**MULTI ESSENCE**

СО ПРИЈАТЕЛЕН ВКУС НА ЈАГОДА, БРУСНИЦА И НА ВАИЛА

13 ВИТАМИНИ + 10 МИНЕРАЛИ + ЛУТЕИН

13 ВИТАМИНИ + 11 МИНЕРАЛИ + ЛУТЕИН 50+

50+ ТАБЛЕТИ

NETO-МАСА: 31 г ДОДАТОК ВО ИСХРАНАТА БЕЗ ГЛУТЕН

NETO-МАСА: 40,5 г ДОДАТОК ВО ИСХРАНАТА БЕЗ ГЛУТЕН

NETO-МАСА: 75 г ДОДАТОК ВО ИСХРАНАТА БЕЗ ГЛУТЕН

ВИТАМИНИ И МИНЕРАЛИ ЗА ВОЗРАСНИ ТАБЛЕТИ

ВИТАМИНИ И МИНЕРАЛИ ЗА ВОЗРАСНИ ТАБЛЕТИ

ВИТАМИНИ И МИНЕРАЛИ ЗА ВОЗРАСНИ ТАБЛЕТИ

ЗА ОПТИМАЛНА ЕФИКАСНОСТ

**ВИТАМИНИ И МИНЕРАЛИ ЗА ВОЗРАСНИ**

Комбинација на **витамини, минерали и лутеин** за секојдневно надополнување на редовната исхрана.

АЛКАЛОИД СКОПЈЕ

Здравјето археј се

# ZBATIMI I KANABISIT PËR QËLLIME MJEKËSORE



**Kanabisi, po ose jo... Disponueshmëria e përdorimit të tij për qëllime mjekësore është tashmë realitet...  
Zgjedhja është e juaja...**

- Kanabisi është padyshim një bimë, përdorimi i së cilës, në formën e përpunimeve të ndryshme, ka qenë i njojur që nga kohët e qytetërimeve të lashta.

E quajnë si "Eliksiri më i mirë i pavdekësisë". Është kahasuar me një "thesar", një "burim të pashtershëm të komponentëve farmakologjikë aktivë". Potenciali i tij kahasohet me potencianin e penicilinës.

Tani gjithnjë e më shumë lind pyetja: "A është ky zbulimi i ardhshëm që do të ndryshojë rrjedhën e trajtimit në mjekësi".

Në fitokomponentët e tij të shumtë, ekspertët gjithnjë e më shumë e dallojnë njashëmrinë me molekulat vitale të organizmit të njeriut: "Nëse do të zbulohej tani dhe jo më shumë se 5000 vjet më parë, do të ishte madhështor dhe i adhuruar në sajë të përbërjes jashtëzakonisht të pasur dhe potencialit të lartë në trajimin e shumë sëmundjeve dhe çrrregullimeve, nga dhimbja deri te kanceri".

Është e qartë se të gjitha këto sekuanca e kanë fjalën për kanabisin, bimën më të diskutueshme në natyrë, e cila më në fund ka përfjetuar çmitizimin e saj, pas më shumë se tetë dekadave ndalim të plotë.

Kanabisi si bimë përmban mbi 500 fitokimikate të njoitura, nga të cilat 120-140 janë kanabinoidë, në gjendje të dekarboksiluar/neutrale, të tretshme në yndyrë dhe në gjendje të karboksiluar/acidike, të tretshme në ujë. Përveç kësaj, përmban edhe terpenet dhe komponimet terpenoide, flavonoide, fitosterole, karotenoide, acide yndyrore të pangopura omega (omega-3, omega-6 dhe omega-9) në raportin më të mirë biologjik, aminoacide, glikozide, vitamina (A, B1, B2, B6, C, D, E, acid folik), pigmentë, alkane, komponime të azotit, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në ndërtimin dhe ruajtjen e integritetit të qelizave dhe funksionimin e duhur të shumë sistemeve në organizmin e njeriut etj.

Përmban kanabinoidet primare; CBD (Cannabidiol), THC (Tetrahydrocannabinol) dhe izomerët e tij, si dhe format e tyre të karboksiluara, së bashku me kanabinoidet e tjera, të pranishme në sasi dukshëm më të ulëta në lule dhe ekstrakte të kanabisit; THCV, CBN, CBC, CBG, CBV, CBDV dhe format e tyre të karboksiluara, si dhe terpenet dhe komponimet terpenoide, flavonoidet, kaotenoidet dhe fitosterolet, janë jashtëzakonisht të rëndësishme për shkak të ndërveprimit të theksuar sinergjik mes tyre.

Kjo i bën ekstraktet e kanabisit të dobishme në parandalimin dhe ruajtjen e mirëqenies, por jo vetëm kaq - nga këtu buron potenciali i saj për të ndihmuar në trajtimin e shumë sëmundjeve dhe çrrregullimeve në organizmin e njeriut:

-gjendjet e stresit, ankthit, nervozizmit, depresionit, pagjumësisë  
-dhimbjet me prejardhje të ndryshme, falë veprimit të saj të shprehur kundër inflamacionit, si dhe

dhimbjet kronike neuropatike

-spazma e muskujve

-glaukoma

-të përzierat dhe të vjellat, sidomos gjatë terapisë me rezatim ose hemoterapisë te sëmundjet malinje, duke ruajtur baraspeshën e florës së zorrëve dhe duke nxituar oreksin

-mungesa e oreksit, anoreksia

-sëmundjet kardiovaskulare dhe problemet e presionit të gjakut, për shkak të potencialit të përmirësimit të punës së zemrës dhe veprimit kardio-mbrojtës

-përgendrimet e larta të lipideve dhe kolesterolit në gjak, si dhe rregullimi i përgendrimit të rritur të glukozës në gjak

-për përdorim lokal, në infeksionet e shkaktuara nga bakteret dhe kërpudhat, madje edhe me rezistencë të theksuar ndaj antibiotikëve dhe antimikotikëve

-Efektet pozitive të përdorimit plotësues të preparave të kanabisit janë të njoitura edhe në sëmundjet malinje, epilepsi, sklerozë të shumëfishtë, sëmundja e Parkinsonit, sëmundjet autoimune etj.

- Një numër i madh i institucioneve shkencore dhe kompanive në këtë fushë, në bashkëpunim me Universitetet në Evropë, Kanada, Izrael, Amerikë dhe Australi, po punojnë për të hulumtuar potencialin e kanabisit në luftën kundër COVID-19. Studimet, të përqendruara në efektet e kanabisit në sistemin imunitar, receptorët ACE2 të qelizave dhe roli i terpeneve në parandalimin e depërtimit të virusit në qeliza, erdhën në përfundimin se Cannabis Sativa mund të përdoret në parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve me SARS-COV-2, virusi që shkakton COVID-19.

Nuk ka dyshim se në të gjitha rastet e tjera kur mjekësia konvencionale, e bazuar në prova, nuk ka përgjigje adekuate ose asnjë përgjigje, natyrisht që arsyetohet përdorimi i trajtimit me kanabis, i cili mund të ketë potencial për të përmirësuar gjendjen si trajtim ndihmës (plotësues) dhe madje të çojë te mundësia e zvogëlimit dhe përashtimit të plotë të terapisë standarde, konvencionale, e cila nuk i jep pacientit efektet e pritshme.

- Së fundi, pas shumë vitesh lufte, në qershor të vitit 2016, Maqedonia ndërmori hapin vërtet të madh, kur me Ligjin për droga narkotike, substancë psikotrope dhe prekursorë, vendi ynë më në fund liberalizoi përdorimin e saj për qëllime mjekësore.

Nismëtarët kryesorë dhe nxitësit e legalizimit ishin qytetarët e Maqedonisë, për të cilët potencial i kanabisit tashmë ishte i njohur, por disponueshmëria e tij ishte e kufizuar me ligj, prandaj me vite të tèra luftuan në dy fronte, me sëmundjen e pakëndshme dhe me ligjin.

Disa vite para legalizimit, si në botë ashtu edhe në vendin tonë, u punua në mënyrë aktive në zhvillimin dhe hulumtimin e kanabisit, si një projekt me interes të veçantë. Kjo për shkak të përdorimit të tij në rritje në mbarë botën, për qëllime mjekësore, për një numër indikacionesh mjekësore në të cilat mjekësia e bazuar në prova nuk ka përgjigje të përshtatshme ose asnjë përgjigje.

Oytetarët e Maqedonisë janë gjithnjë e më të vetëdijshëm për magjinë e kanabisit, sinergjinë e mrekullueshëm që natyra i ka dhënë një bime të vetme dhe përfitimet që ofron për qëllime mjekësore.

Menjëherë pas miratimit të Ligjit, nga mesi i vitit 2016, në Maqedoni filloj prodhimi serioz industrial i ekstrakteve të kanabisit mjekësor dhe produkteve të gatshme për qëllime mjekësore, në të cilat përfshihen edhe ekstraktet e tij. E gjithë kjo ndodhi në një kohë, kur as në vendin tonë, as në rajon, nuk kishte fare konkurrencë. Mungesa e konkurrencës nënkuptonte mungesë edhe të përvojës.

Maqedonia u shndërrua në një shembull në rajon dhe më gjérë. Ishte e para që filloj dhe po zhvillohet vazhdimisht si shtet udhëheqës në rajon, si shembull i shumëllojshmërisë, sasisë dhe cilësisë së lartë të preparateve të kanabisit nga prodhimi vendas, të parapara për qëllime mjekësore.

Zgjedha "po" ose "jo" për sa i përket pranimit të trajtimit me kanabis, mbetet të vendoset nga pacienti dhe mjeku specialist, të cilil pacienti i ka dhënë besimin.


Por jini të kujdesshëm!

Jo çdo kanabis, jo në çfarëdo forme, jo me çfarëdo përbërje, jo me çfarëdo përqendrimesh.

Jo në çfarëdo paketimi, jo në çfarëdo doze.

Jo nga cilido prodhues.

Së fundi, jo me çfarëdo cilësie.



Gordana Trendovska Serafimovska

Farm. Dipl.

Spec. për kontrollimin dhe ekzaminimin e barnave

Këshilltare për kanabis

REPLEK FARM DOOEL, SHKUP

# КАНОИЛ® БИО

Екстракт од канабис (Cannabidiol)

Ја подобрува општата здравствена состојба

- Го подобрува имунитетот
- Помага при стрес
- Регулира покачен крвен притисок, шеќер и масти во крвта
- Го намалува нагонот на гадење и повраќање

## БЛАГОСОСТОЈБА ОД ПРИРОДАТА

КАНОИЛ® БИО не претставува замена за стандардната пропишана терапија



1890 ден.\*

2361 ден.\*

\*препорачана малопродажна цена

# Kapsllëku gjatë shtatzënisi

Kapsllëku gjatë shtatzënisi është një problem i zakonshëm me të cilin përballen pothuajse gjysma e të gjitha grave shtatzëna. Kapsllëku ndodh kur ka lëvizje të rënda dhe të rralla të zorrës së trashë dhe kalim të jashtëqitjes së ngurtë. Pacienti ankohet për dhimbje të barkut, siklet dhe fryrje.

Cilët janë shkaktarët e kapsllékut gjatë shtatzënisi?

Në përgjithësi, shqetësimi, ankthi, mungesa e lëvizjes dhe dieta me pak fibra janë shkaktarët më të shpeshtë të kapsllékut. Kapsllëku gjatë shtatzënisi vjen për shkak të rritjes së hormoneve të progesteronit që relaksojnë të gjithë muskujt në trupin e njeriut, duke përfshirë edhe muskujt e zorrëve, gjë që sjell deri te lëvizja më e ngadaltë e ushqimit dhe mbeturinave të tij përmes traktit gastrointestinal. Kjo çon deri te përthithja e një sasie më të madhe të ujtit nga jashtëqitja dhe kështu ajo bëhet më e thatë dhe e ngurtë.

Në këtë mekanizëm mbështeten edhe barnat që mund të përdoren në shtatzëni për të trajtuar çregullimin në fjalë. Këto barna quhen laksativë dhe ka lloje të ndryshme të tyre, varësisht nga mekanizmit të veprimit:

-Laksativët osmotikë veprojnë duke tërhequr ujin në zorrë. Shembuj të osmotikëve janë kripërat (të tillë si hidrokсид magnezi dhe bisfosfonat natriumi) dhe sheqernat (të tillë si laktuloza dhe glikol polietileni). Këto preparate zvogëlojnë vlerën pH të përbajtjes fekale në zorrën e trashë dhe shkaktojnë diarre osmotike duke tërhequr ujin në zorrë. Barnat osmotike nuk përthiten mirë nga zorrët, prandaj shumë pak hyjnë në qarkullimin e gjakut. Kjo do të thotë se ekspozimi ndaj tyre gjatë shtatzënisi është i vogël.

-Në mesin e fibrave ose celulozës përfshihen lëvorja nga fara e dellit, psiliumi dhe metilceluloza. Fibrat lidhin 60 deri në 100 herë më shumë ujinë sesa masa e tyre dhe kështu fryhen në pjesën e poshtme të traktit digestiv. Ato stimulojnë peristaltikën në mënyrë natyrore fiziologjike. Meqenëse këta përbërës në përgjithësi nuk hyjnë në qarkullimin e gjakut, nuk janë as të dëmshëm për gruan shtatzënë.

-Ndër zbutësit e jashtëqitjes përfshihen dokusat natriumi dhe glicerina.

-Stimuluesit më të përdorur janë sena, bizakodili dhe vaji i ricinit (i bëre nga fara e ricinit), si lubrifikantë. Këto produkte hyjnë në qarkullimin e gjakut në sasi të vogla, kështu që mund të ketë një ekspozim të lehtë për shtatzënин. Stimuluesit dhe këta lubrifikantë mund të shkaktojnë ngërçë në stomak, të cilat mund të janë serioze gjatë shtatzënisi.

Ja disa gjëra që mund të bëhen për të parandaluar kapsllékun ose për të trajtuar vete nëse e keni përjetuar tashmë:

- Ushqehuni me një dietë të pasur me fibra: është mirë që të konsumoni 25 deri në 30 gram në ditë fibra nga frutat, perimet, drithërat përmëngjes, buka integrale, kumbullat dhe krundet. Kjo ndihmon për të krijuar jashtëqitje më voluminoze.

- Pini shumë lëngje: pirja e mjafaueshme e lëngjeve është e rendësishme, sidomos kur rritja e konsumimit të fibrave ndihmon për jashtëqitje më të buta. Pini 10 deri në 12 gota lëngje çdo ditë. Është kombinimi i një diete të pasur me fibra së bashku me sasi të mjafaueshme të lëngjeve që më së miri ju ndihmon të nxirri jashtë mbeturinat. Djersa, klima e xehëtë dhe e lagësht dhe ushtrimet trupore mund t'ju rrisin nevojën për sasi shtesë të lëngjeve.

- Bëni ushtrimet pjesë të rutinës, sepse nëse nuk jeni aktive, ka më shumë të ngjarë që të vuani nga kapsllëku. Ecja, noti dhe ushtrime të tjera të moderuara do të ndihmojnë punën e zorrëve duke i stimuluar ato. Planifikoni ushtrimet tri herë në javë, nga 20-30 minuta.

- Zvogëloni ose mënjanoni shtojcat e hekurit: shtojcat e hekurit mund të kontribuojnë në bërjen kaps. Ushqimi i mirë shpeshherë mjafur për të plotësuar nevojat tuaja për hekur gjatë shtatzënisi. Marrja e dozave më të vogla të hekurit gjatë ditës, në vend se marrja përmëherë, mund të zvogëlojë kapsllékun.

A është kapsllëku gjatë shtatzënisi ndonjëherë serioz?

Zakonisht jo, por ka raste kur kapsllëku gjatë shtatzënisi mund të jetë simptomë e një problemi tjeter. Nëse keni kapsllëk të rëndë të shqeruar me dhimbje barku ose nëse kapsllëku ndryshon me diarre ose përzihet me mukozë ose gjak, telefononi menjëherë mjekun tuaj.

Gjithashtu, shtërzimi gjatë lëvizjes së zorrës së trashë ose kalimi i një jashtëqitjeje të fortë mund të çojë në shfaqjen e hemorrhoidave ose të përkqësosjë ato ekzistueset, të cilat janë vena të fryra në zonën e rektumit. Hemoroidet mund të janë jashtëzakonisht të pakëndshme, edhe pse rrallë shkaktojnë probleme serioze. Në shumicën e rasteve, ato zhduken menjëherë pas lindjes së fëmijës suaj. Megjithatë, nëse dhimbja është e fortë ose keni gjakderdhje nga rektumi, telefononi mjekun tuaj.

Mr. Dr. Simonida Kotlarova Poposka  
Specialiste e gjinekologjisë dhe obstetrikës  
IPSH REMEDIKA, SHKUP





НОВО  
ПАКУВАЊЕ  
ВО ФОРМА  
НА СПРЕЈ



#### ПОЛИАЛКОХОЛЕН РАСТВОР

- Избалансиран состав од алкохол со доказан, силен микробициден ефект, со нанесени 2-3 ml.
- Дејствува во рок од 30 секунди и не ја оштетува кожата на рацете.
- Дејствува против бактериски соеви како *Staphylococcus aureus* (MRSA), *Mycobacterium tuberculosis*, *Pseudomonas aeruginosa*, *Escherichia coli*, *Enterococcus faecalis*; фуни како *Candida albicans* и *Aspergillus niger*; одредени типови вируси како *Hepatitis A, B и C*, HIV, Rota, Influenza virus, Herpes, SARS CoV1, SV40 и др.
- Соодветен е за хируршка дезинфекција на рацете во медицински установи.



#### ТЕЧЕН САПУН MEDICAL (400 ml) И ТОАЛЕТЕН САПУН MEDICAL (100 g)

- Ефикасно ги отстрануваат бактерите и нечистотите од кожата
- Со додаток на глицерин којшто спречува сушење на кожата на рацете
- Со пријатен, дискретен мирис

#### ГЕЛ ЗА ДЕЗИНФЕКЦИЈА НА РАЦЕ MEDICAL (75 ml и 400 ml)

- Овозможува брза дезинфекција на рацете, без употреба на вода и сапун
- Уништува 99,9 % од бактерите
- Дејствува по 30 секунди од нанесувањето

#### АНТИБАКТЕРИСКИ ВЛАЖНИ МАРАМЧИЊА MEDICAL

- Брзо и ефикасно ги чистат рацете, без употреба на вода и сапун
- Ги уништуваат најчестите бактерии кои се скрекаваат на кожата
- Не содржат алкохол

АЛКАЛОИД  
СКОПЈЕ

Не смејте да се употребува за громивање на телесните празници, на слузокожата и на очите, како и на јагтетена кожа. Ако тоа се случи, веднаш темелно измите го местоот со млад вода, а во случај на труење, веднаш побарајте лекарска помош. Medical растворот секогаш чувајте ги вон дојгат на деца а заради испарувањето на алкохолите, при негова апликација држете ги рацете подагеку од лицето.

GOOD  
NATURE

ЧАЈНА МЕШАВИНА  
КОЈА ПОВОЛНО  
ДЕЈСТВУВА ЗА  
ДЕТОКСИКАЦИЈА  
НА ОРГАНИЗМОТ



[www.goodnature.mk](http://www.goodnature.mk) | [www.facebook.com/GoodNatureMKD](https://www.facebook.com/GoodNatureMKD) | [www.instagram.com/goodnaturemk](https://www.instagram.com/goodnaturemk)

\* Ве молиме задолжително да го прочитате упатството за користење на чајот кое се наоѓа на амбалажата и за дополнителни информации консултирајте се со вашиот лекар или фармацевт.

АЛКАЛОИД  
СКОПЈЕ

# BETTY KËTË MUAJ, DALLOJMË

%



LIVSANE  
pije e nxeh të me  
fruta malorë  
10 qese



LIVSANE  
pije e nxeh të me  
xhenxhefil, mjaltë  
dhe limon  
10 qese



LIVSANE  
Çaj përrallë  
dimërore  
20 qese



IMMUN ACTION  
60 kapsula



UTIEMANOZ®  
Direkt  
10 qese



**FERRO EV**  
20 shishka prej  
10ml



**LINEX® COMPLEX**  
14 kapsula



**PROBIOKID IMMUNO®**  
10 qese



**SNAIL COMPLEX**  
2 + 1 falas



**Bokvica shurup  
gjethje dielli + A-D-C**  
150g



**A + D<sub>3</sub> Tretesirë me pika**  
10ml



**Shurup për duhanpirësit  
për kollën e duhanpirësve**  
150ml



Para përdorimit, Ju lutemi lexoni udhëzimet e paketimit me kujdes.  
Për më shumë informacion kontaktoni mijekun ose farmacistin tuaj.

# PSE GJUMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR FËMIJËT DHE CILAT JANË PASOJAT E GJUMIT TË PAMJAFTUESHËM



NDËRSA FËMIJËT TUAJ JANË DUKE FJETUR, NË TRURIN E TYRE NDODHIN GJËRA TË MREKULLUESHME

Ndryshe nga ne të rriturit, fëmijët kanë nevojë për më shumë gjumë. Gjumi është tejet i rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve dhe është me rëndësi të madhe që t'u krijoni rutina dhe zakone të shëndetshme të gjumit. Disa nga arsyet pse gjumi nuk duhet të anashkalohet dhe duhet të jeni të kujdeshëm për gjumin e fëmijëve tuaj janë:

1. Fëmijët rriten dhe zhvillohen ndërsa flenë! Hormoni i rritjes, somatotropina, prodhohet gjatë gjumit. Hormoni i rritjes vepron në pjesën më të madhe të indeve të trupit, në të cilën stimulon sintezën e proteinave të nevojshme për rritjen. Te fëmijët, ky hormon sekretohet më së shumti gjatë gjumit të natës, kur hyjnë në fazën e thellë të gjumit. Faza e thellë e gjumit ndodh në fillim të natës, kurse nëse kjo fazë pengohet, rritja nuk do të zhvillohet normalisht. Nëse një natë e gjumit të parregullt nuk mund ta dëmtojë rritjen, problemet kronike të gjumit në fëmijëri po që mund ta bëjnë. Hulumtimet e fundit tregojnë se fëmijët me sasi të zvogëluar të hormonit të rritjes kanë probleme me gjumin, nuk flenë mjaftueshëm, ndryshe nga fëmijët që kanë hormon normal të rritjes.

2. Ndërsa fëmijët flenë natën, truri i tyre punon me shpejtësi të plotë dhe përpunon përjetimet e asaj dite. Ata përpunojnë të gjithë informacionin e mbledhur dhe mbushen me njohuri dhe aftësi të reja që mund t'u nguliten në kujtesë, duke qenë se miliona lidhje të reja nervore formohen gjatë gjumit të natës. Me fjalë të tjera, fëmijët mësojnë ndërsa flenë! Nëse foshnja juaj nuk fle mjaftueshëm, ky proces çrrullohet.

3. Hormonet që regjistrojnë urinë dhe oreksin, si insulina dhe kortizoli (hormoni i stresit) gjithashtu shqetësohen nga gjumi i pamjaftueshëm. Fëmijët e vegjël, të cilët një periudhë të gjatë flenë me ndërprerje dhe bëjnë gjumë të pamjaftueshëm, kanë një nivel jashtëzakonisht të ulët të insulinës, gjë që mund të çojë në diabet dhe probleme me peshën. Studimet e fundit tregojnë se



fëmijët që kanë çrrullime të gjumit janë në rrezik për obezitet. Fëmijët që nuk flenë mjaftueshëm kanë nivel të lartë të kortizolit, i cili u shkakton stres. Gjumi i mirë zvogelon stresin dhe forcon imunitetin. Fëmijët e ngopur me gjumë janë fëmijë të shëndetshëm dhe me humor të mirë. Sasia e mjaftueshme e gjumit ka një efekt jashtëzakonisht pozitiv në zhvillimin e inteligjencës emocionale tek fëmijët. Kur fëmijët janë të ngopur me gjumë, ata kanë përqendrim shumë më të mirë dhe më afatgjatë, prandaj janë të gatshëm të eksplorojnë botën rreth tyre dhe të mësojnë gjëra të reja.



Por si ta kuptoni nese fëmija juaj ka nevojë për më shumë gjumë?

Pavarësisht nga mosha, këto shenja tregojnë se ka nevojë për më shumë gjumë:

1. Emocionalitet i shprehur (shpërthime të shpeshta inati, ndryshime të humorit, hidhërohet lehtë, pa durim)
2. Vështirë zgjohet në mëngjes
3. Vështirësi në përqendrim ose për t'u fokusuar në një lojë
4. Dremite të gjata ose të tepruara
5. Hiperaktivitet
6. Vështirë bie në gjumë (rraskapitje)
7. Bie në gjumë sapo të vë kokën në jastëk (një fëmije me zakone të shëndetshme të gjumit i duhet rreth 20 minuta kohë për t'u zhytur në gjumë)
8. Rritje e oreksit
9. Rënia e shpeshtë dhe pakujdesia
10. Të folurit e tepërt (më shumë pyetje sesa është normale, biseda të shpejta që s'kanë lidhje me njëra-tjetrën). Në foton më poshtë, mund të shikoni se sa orë gjumë kërkohet për mosha të ndryshme.

Gjumi është një nevojë themelore, ashtu si të ngrënët, pa të cilën nuk mund të jetojmë.

Për sa kohë që fëmijët tanë nuk janë në gjendje të kujdesen vetë për ushqimin dhe gjumin e

tyre, është detyra jonë si prindër

që t'u sigurojmë ushqim dhe gjumë të shëndetshëm, t'u krijojmë zakone të shëndetshme të të ushqyerit dhe gjumit, duke vendosur dhe forcuar themelet për një fëmijëri të shëndetshme.



MOS HARRONI SE FËMIJËT E NGOPUR ME  
GJUMË, JANË FËMIJË TË SHËNDETSHËM  
DHE ME HUMOR TË MIRË!



Sanja Gjorgjeva  
trajnere e certifikuar e gjumit për foshnja dhe fëmijë



**BioGaia™**  
Lactobacillus reuteri Protectis  
Пробиотски капки



БиоГаја ПроТектис капки е граничен производ што содржи Lactobacillus reuteri Protectis кој помага во возобновување на природниот баланс во превата и одржување на истиот. Се користат како безбеден и докажан пробиотик кај деца вклучувајќи ги новороденчињата како и прематурните новородени деца. Капките се користат за:

- Одржување на нормалниот превен микробиот посебно кај децата родени со Царски рез
- Инфантилни колики(грчеви), регургитации, констипација, функционална абдоминална болка
- Го намалува ризикот од појава на некротизирачки ентероколитис

- Дополнителна терапија на антибиотското лекување
- Подобрување на имунитетот
- Спречување на појава на егзема
- Го намалуваат присуството на helicobacter pylori

# PARASHIKIMI I TENDENCAVE TË MODËS 2021

Mos e besoni po deshët, por viti 2021 veç sa s'ka mbërritur. Kjo do të thotë se jemi rrugës drejt tendencave krejtësisht të reja të modës. Duke analizuar koleksionet S/S 21, veçova disa tendencia që me kënaqësi do t'i vishja menjëherë, por edhe ato që me kënaqësi do t'i kapërceja.

E pra, cilat u gjenden në këtë listë?

Rezulton se ka shumë për të parë, nga motivet dhe modelet mbresënëse që përsëriten kudo, deri te veshjet bazike që përshtaten në mënyrë të përkryer me veshjet e shtresuara dhe një ngjyrë e veçantë që do të gjendet në dollapin e secilit që ndjek modën.



## Bluzat e ngushta

S'ka gjë që më pëlqen më shumë se sa veshjet bazike me shumë përdorime, të cilat janë gjithçka përvçeze bazike. Prandaj, këto bluza që mund të quhen "lëkurë e dytë", janë një nga tendencat e dalluara që i kam me qejf për sezonin e ardhshëm. I parë në pistat S/S 21 të dizajnerëve si Miu Miu, Givenchy dhe Marin Serre, ky është artikulli me të cilin do të eksperimentojë çdo e dhënë pas modës gjatë muajtë ardhshëm, këtë jua garantoj. Pavarësisht nëse kombinohet me triko sportive ose mbahet nën triko të thurur dhe pantallona të gjera, siç e pamë në shfaqjet e markës Prada, hapësira e përdorimit të tyre është e pafundme.

## Jelekët

Trendi që më ngjall kureshtjen për vitin e ardhshëm janë jelekët. Jeleku i thurur me pulovër ka një moment të madh rikthimi këtë sezon dhe mendoj se do të ketë një evolucion në ta. Tani do të vishni jekët shushuritës, të mbushur me tegela, në përgjithësi versione më të ngrohta, kurse me ardhjen e pranverës, do të kaloni në variante të lehta.

## Rozë "bubblegum"

Kam qenë gjithmonë adhuruese e ngjyrave të guximshme dhe jam shumë e lumtur që kjo ngjyrë e fuqishme rozë do të freskojë dollapët tanë në sezonin e ardhshëm. Ngjyrat e tillë janë gjithmonë të fortë në të shprehurit e modës, sidomos kur kombinohen me ngjyra asnjaniëse, si ngjyrë hiri, krem dhe të ngjashme. Keni diçka, "Barbie", nëpër shtëpi? Nëse nuk keni, vraponi për të marrë!



## "Lidhëset"

Tashmë kemi parë një version të këtij trendi vitin e kaluar, në formën e lidhëseve të korsesë, mirëpo këtë vit janë transformuar në detaje shumë më delikate që i plotësojnë edhe veshjet më të thjeshta.

## Pantallonat e gjera

Kishte një mori pantallonash të gjera të lirshme në pasarelat e sezonit pranveror dhe mua veçanërisht më pëlqeu se si ishin stiluar ato të markës Fendi. Ky trend të jep një ndjesi aq të hatashme sa që nuk mund të mos dukesh e hijshme në to. Por unë mendoj se janë të rezervuara vetëm për ata me trup më të hollë. Vajzave më të plota nuk u shkojnë shumë për shtat pantallonat e gjera.

## Mikro mini fundet

Skajet e fundeve sa shkonin e ngjiteshin më lart në sezonin pranveror të vitit 2021, veçanërisht në shfaqjen e Miu Miu, ku minifundet mikroskopike të kombinuara me trikotazh me mëngë të shkurtra më transportuan në vitet '60. Për ata që kanë këmbë të holla ky është një lajm shumë i mirë. Për ne më të plotat, është vetëm lajm.

## Zinxhirët e gjatë

U gëzoja shumë kur pashë zinxhirë më të gjatë në pistat S/S 21 dhe përfundimisht mezi po pres që ta përshtat këtë trend të bizhuterive në garderobën time. Në përgjithësi, unë gjithmonë mbaj gjerdanë të mëdhenj dhe të gjatë, kështu që jam e lumtur që do të ketë shumë më tepër në treg këtë vit. Ky artikull strukturor nga Bevza më tërhoqi vërtet vëmendjen.

## Fusha e shahut

Fusha e shahut është një trend që vazhdon të ndërtohet që nga viti i kaluar, dhe jam e ngazëllyer që do të vazhdojmë ta shohim edhe në S/S 21. Është shumë më emocionuese sesa shiritat ose pikat. E adhuroj setin grafik në tri pjesë (plus këpucët!) të Dolce & Gabbana. Variacionet e temës në ngjyra të papritura janë mjaft zbavitëse dhe freskuese.

## Tangat dhe hapjet e integruara


Diçka shumë seksi dhe e mrekullueshme u shfaq në pasarelat modës që më tërhoqi vëmendjen. Ky trend, ndonëse mund të mos jetë për çokënd, në doza të moderuara mund të përkthehet edhe në kombinime të përditshme. Për shembull, këto pantallona pothuajse klasike të zeza me hapje diskrete mund të kombinohen lehtësisht me një bluzë me mëngë të shkurta ose pulovër të gjërë.

## Bluza të thurura me mëngë

Bluzat e thurura me mëngë janë në modë për momentin dhe pamja do të vihet edhe më shumë në qendër të vëmendjes në vitin 2021. Mezi pres të provoj disa silueta të ndryshme, si një mënyrë e lehtë për ta sjellë atë sofistikim modern në atmosferë.



Edhe pse të përbledhura kështu shkurtimi, këto janë tendencat e modës që shquhen në krijimet e dizajnerëve për sezonin e ardhshëm, se sa dhe si do të vijnë në vendin tonë mbetet përtu parë. Nga ana tjetër, dua të shtoj se megjithatë bëhet fjalë për tendenca që përfshijnë vetëm modele të përmasave 0, përkatesisht pak prej tyre janë edhe për gratë e përditshme. Artikuj të tillë do të gjeni në mini linjat për gratë me forma - franplusfashion, ku përpinqemi t'ju sjellim më afër tendencave të modës, të përkthyera në variante për gratë normale, pa mos harruar të përmend klasikët e modës, që duhet të gjenden në dollapin e çdo gruaje.



*Frosina Fran  
stilist*

# BOTA E BRENDSHME E FËMIJËVE TË TALENTUAR

*Njohja dhe shprehja e ndjenjave  
te fëmijët e talentuar*

## Njohja dhe shprehja e ndjenjave te fëmijët e talentuar

Zhvillimi emocional është një nga proceset më të rëndësishme në zhvillimin e personalitetit, që zhvillohet nën ndikimin e maturimit dhe të mësuarit shoqëror. Reagimet emocionale i ndjekin të gjitha përvojat tona, ato janë një proces psikik me të cilin i japid vlerë asaj që përjetojmë dhe u qasemi në mënyrë subjektive ngjarjeve, njerëzve dhe veprimeve tona. Përveç përvojave subjektive, ky proces ngjall ndryshime organike dhe të sjelljes. Këto ndryshime janë të ndërlidhura: si ndihemi ashtu edhe sillemi.

*Si lindin  
empcionet?*



### Si lindin emocionet?

Vëzhgimi i një fenomeni të caktuar shkakton reagime të drejtëpërdrejta trupore, kurse emocioni është përgjigjja jonë ndaj atyre reagimeve trupore. Stimuli udhëton nga receptorët në talamus ku sinjalë përkthehet në gjuhën e trurit. Pjesa më e madhe e sinjaleve transmetohen në pjesën e korteksit ku analizohet dhe interpretohet kuptimi i tyre dhe përgatitet një përgjigje. Nëse përgjigjja është sinjal emocional, ajo i dergohet amigdalës, e cila është një roje mendore dhe emocionale që mund të shkaktojë përgjigje emocionale para se truri i arsyeshëm të vlerësojë se çfarë po ndodh me të vërtetë. Shpërthimet emocionale para përfshirjes së trurit të arsyeshëm më shumë e pengojnë sesa e ndihmojnë personin, ndërsa kjo varet nga ndërveprimi i korteksit paraballor dhe sistemit limbik, pjesë e neokorteksit e cila është përgjegjëse për vetëkontrollin dhe qetësimin e reagimeve emocionale.

### Zhvillimi i emocioneve te fëmijët

Që nga lindja, fëmijët reagonjë ndaj ndikimeve të jashtme dhe ngjarjeve në trupin e tyre, ndonëse foshnjat reagonjë ndryshtë kur janë të uritur, kur kanë ngërçë ose kur kanë të



ftotë. Pas lindjes, fëmija mund të ketë vetëm një gjendje të përgjithshme emocionale të papërcaktuar, që quhet ngacmim i përgjithshëm dhe që ndodh pavarësisht nëse fëmija përgjigjet pozitivisht ose negativisht ndaj stimulit. Pas tre muajsh mund të veçohen dy reagime themelore emocionale: rehatia (kënaqësia) dhe parehatia (shqetësimi).

Deri në muajin e gjashtë, nga parehatia dallohen tre emocione: zemërimi, neveria dhe frika. Pak më vonë, deri në muajin e nëntë, nga rehatia dallohet dashuria për të riturit. Rreth muajit të trembëdhjetë, kjo e fundit shndërrrohet në dashuri për fëmijët. Në mes të vitit të dytë, fëmija mund të reagojë me xhelozit, ndërsa në muajin e njëzetënjetë është në gjendje të shprehë gëzim.

### Karakteristikat e emocioneve të fëmijëve

Empcionet e fëmijëve ndryshojnë ndjeshtë nga emocionet e të riturve. Këto ndryshime vërehen në mënyrën e shfaqjes së emocioneve, shprehjes, intensitetit, shpeshtësisë dhe kohëzgjatjes. Fëmijët reagonjë menjëherë ndaj të gjitha ndryshimeve, ndërsa emocionet e tyre janë të dukshme përmes manifestimit të jashtëm: shprehjes dhe lëvizjes së tërë trupit. Empcionet e fëmijëve janë të forta dhe jetëshkurtër. Ashtu siç ndryshon stimuli, ndryshon edhe përgjigja pozitive apo negative emocionale. Të gjitha mënyrat e reagimit emocional pa kontroll emocional e bëjnë fëmijën të shprehë emocionet më ndryshtë nga rriturit.

### MUND TË VEÇOJMË DY GRUPE EMOCIONESH: EMOCIONE THEMELORE OSE PARËSORE DHE KOMPLEKSE

#### Empcionet parësore



Empcionet e para që dallojnë janë emocionet themelore ose parësore: zemërimi, frika, gëzimi dhe trishtimi. Tre të parat rrisin tensionin dhe inkurajojnë aktivitetin, ndërsa trishtimi është një emocion me tension dhe aktivizim më të ulët. Zemërimi dhe gëzimi pririn drejt qëllimit, ndërsa frika është një emocion që anon nga shmangja ose shpëtimi nga rreziku.

Zemërimi - shfaqet kur një pengesë ndërhyr në aktivitetin ose arritjen e ndonjë qëllimi, çkaçon në zhgënjim. Zemërimi mund të shoqërohet me agresion të drejtëpërdrejtë ose të matur. Me rritjen e fëmijëve, reagimet fizikalit agresiv bien, kurse ato verbale riten, por për shkak të pasojave të paleverdishme, fëmijët mësojnë se si ta kontrollojnë këtë emocion.

Frika - shfaqet në një situatë që kërçenon integritetin e personit. Frika shkaktohet nga ndryshime të papritura, pasi ato zgjelojnë kontrollin mbi situatën dhe rrisin pasigurinë se rreziku mund të shmanget. Frika shoqërohet me ndryshime të forta në organizëm dhe sjellje. Frika mund të sillet nga një frikë e vogël në një ndjenjë tmerri.

Gëzimi - shfaqet pasi të arrihet qëllimi i dëshiruar. Intensiteti i gjëzimit varet nga vlera e qëllimit të arritur, niveli i tensionit të mbledhur gjatë aktivitetit motivues dhe momenti në të cilin qëllimi arrihet ndërsa tensioni zgjelohet.

Hidhërimi - ndodh pas humbjes së dikçaje të cilën e kemi synuar ose objektit që e kemi dashur. Të fëmijët, hidhërimi zhvillohet më vonë se emocionet e tjera kryesore, për shkak të kompleksitetit të strukturës së situatës në të cilën shfaqet ky emocion. Hidhërimi kërkon të kuptuarit për humbjen dhe pasojat që sjell ajo. Intensiteti mund të sillet nga një i matur deri në dëshpërimin më të madh për shkak të humbjes.



Zhvillimi emocional është një nga proceset më të rendësishme në zhvillimin e personalitetit, që zhvillohet nën ndikimin e maturimit dhe të mësuarit shoqëror.

Neveria – emocion parësor i shkaktuar nga objekte të ndryshme kur i shohim, nuançim, shijojmë ose prekim ato. Karakterizohet nga gjendje të pakëndshme shqisore dhe motorike, ndjesi trupore të shkaktuar nga të përzierat, prirja për të vjellë dhe reagime të tjera. Neveria shoqërohet nga një prirje e lartë për të shmangur.

#### Emocionet komplekse

Me moshën vjen deri te lidhja e qëndrueshme e emocioneve me proceset e tjera psikike: kognitive dhe konative. Zhvillimi i tyre lidhet me proceset e socializimit dhe standartet e vlerësimit.

Ky grup përfshin emocionet që lidhen me vetëvlerësimin, si ndjenjet e suksesit dhe dështimit, krenarës, frikës, turpit, fajit dhe pendimit.

Ndjenja e suksesit – ndjek vetëvlerësimin subjektiv se rezultati është arritur, ndërsa rezultati i pafavorshëm çon në ndjenjën e dështimit. Të dyja emocionet lidhen me nivelin e tyre të aspiratës dhe motivimit për të arritur.

Ndjenja e krenarës – shfaqet me përvetësimin e vlerave relativisht të larta të personalitetit ose rolit të dikujt, ndërsa ndjenja e kundërt, e frikës, shfaqet me vetëdijen për të metat e veta ose veprimet e pahiqshme. Ky emocion shfaqet te fëmija pas formimit të unit të tij (viti i tretë). Për të zhvilluar këtë ndjenjë përdoren standartet e jashtme shoqërore për vlerësimin e sjelljes. Ndjenja e fajit – shfaqet te personi i cili ndjen se ka shkelur normat morale dhe të sjelljes, ndërsa shoqërohet nga brejtja e ndërgjegjes. Pendimi është një emocion i pakëndshëm që shfaqet kur kujtojmë sjelljen tonë për shkak të së cilës nuk kemi ndërgjegje të qetë. Intensiteti i kësaj ndjenje lidhet me përvojën e mëparshme.

#### Emocionet që lidhen me njerezit e tjera

Ky grup i emocioneve përfshin: dashurinë, xhelozinë, urrejtjen, përbuzjen, zilinë, keqardhjen, tèrbimin, respektin e përzier me frikë.

Dashuria – është një ndjenje që përmban ndjenjen e afermit, butësisë dhe lidhjes me personin që na tèrheq. Te fëmijët, dashuria ndaj nënës ndodh në vitin e parë, dhe për fëmijët e tjera në fillim të vitit të dytë.

Urrejtja – është një ndjenje në strukturën e së cilës ndodhen ndjenjet e mospëlqimit, zembrapsjes dhe neveritjes.

Xhelozia – është ndjenjë që shfaqet si reagim ndaj një rreziku real ose të imaginuar të humbjes së objektit të dashur. Ky emocion shfaqet në gjysmën e dytë të vitit të dytë të jetës së fëmijës. Ndaj xhelozisë, fëmija mund të reagojë hapur, me agresion fizik apo verbal, ose fshehurazi, me papavajtje, frikë, belbëzim.

Zilia – është një emocion negativ që shfaqet te një person në situata kur vëren se personi i afërt posedon ose arrin atë që e dëshiron edhe vetë ai.



prof. dr. Slagjana Angelkoska  
psikolog

**Празнична еуфорија**

Нова лимитирана едиција на четките за заби CURAPROX CS 5460 ultra soft

CURAPROX

CURAPROX

SWISS PREMIUM ORAL CARE



Четките за заби Curaprox CS5460 можете да ги купите во аптеките и специјализираните дрогери.

ИНТЕРДЕНТАЛ ДОООЛ  
ул. Георги Поп Христов 2/2-1М  
1000 Скопје

Телефон: 02/ 505 32 60  
078/ 386 306  
e-mail: info@interdental.mk

Curaprox Macedonia  
 curaprox\_macedonia  
[www.interdental.mk](http://www.interdental.mk)

# Përse mjeku pyet për sëmundjet që i kemi në familje?



Për shëndetin dhe idenë e ruajtjes së shëndetit është e rëndësishme të njihni historinë familjare të shëndetit. Familjet kanë shumë faktorë të përbashkët, si gjenet, maledisi, mënyra e jetesës dhe të ngjashme. Së bashku, këta faktorë jepin çelësin për gjendjet mjekësore që mund të “barten nga brezi në brez”.

Shumë familje kanë një sëmundje që duket se “barten nga brezi në brez”. Të dhëna të rëndësishme për të afermit janë mosha kur është diagnostikuar sëmundja, kush nga familja ka vdekur, nga çfarë dhe në çfarë moshe. Kur merret parasysh rreziku për një sëmundje, sa më e afërt të jetë lidhja familjare dhe sa më i ri të ketë qenë personi kur i është shfaqur sëmundja, aq më i lartë është rreziku i mundshëm. Nuk është e rrejtë nëse nëna (brezi i parë) është sëmurë në moshën 30 vjeçare (e re) dhe gjyshi (brezi i dytë) në moshën 75 vjeçare (mosha më e vjetër).

Historia familjare e sëmundjeve, sëmundjet e një ose më shumë anëtarëve të familjes, identifikon njérëzit me rrezik më të lartë (se zakonisht) për një sëmundje të caktuar. Çregullimet mjekësore që mund të “barten nga brezi në brez” janë diabeti, presioni i lartë i gjakut, sëmundjet e zemrës, tromboza (anomalitë në rrugën e koagulimit), astma, lloje të caktuara të kancerit, mbipesha, çmenduria, artriti (artriti reumatoid, përdhesi, spondiliti ankirozant), sëmundjet e veshkave, depresioni, osteoporozë, çregullimet autoimune (lupus, probleme me tiroïden, sëmundja celiac).

Të qenit në dijeni për një sëmundje që “bartet” ndër familjen tonë mund të shkaktojë frikë, por kjo nuk do të thotë se patjetër do të vuajmë nga sëmundja, edhe pse gjasat janë më të mëdha se te njérëzit e tjera. Duke pasur parasysh të dhënët, mjeku mund të përcaktojë nëse ka rrezik në rritje për ndonjë sëmundje. Informacioni rrëth sëmundjeve në familje ndihmojnë mjekun të dije se cilat teste dhe ekzaminime janë të nevojshme dhe në çfarë moshe.

Ekzaminimi nënkuption kërkimin e shenjave të hershme, praninë e mundshme të sëmundjes ende të padiagnostikuar ose çregullimin te njérëzit e shëndetshëm pa simptoma. Për më tepër, mjeku mund të rekomandojë ndryshimin e faktorëve që mund të ndryshohen (faktorët e maledisit, mënyra e jetesës), meqenëse nuk mund t'i ndryshojmë gjenet.

Materiali i trashëguar, gjenet, luajnë një rol të madh në atë se kush jemi, gjegjësisht ne jemi ata që jemi për shkak të gjeneve. Gjenet përbëhen nga acidi deoksiribonukleik, ADN. Kodi i ADN-së është një kombinim unik i informacionit nga e éma dhe i ati. Përzgjedha se cilat gjene do t'i marrim nga e éma

dhe cilat nga i ati është e rastësishme. Njerëzit kanë rrëth 20,000-25,000 gjene, 99% e të cilave ka shumë gjasa të janë të njëjtë në mesin e të gjithë njerezve. Pjesa e vogël e gjeneve të ndryshme janë përgjegjëse për dallimet që shohim në gjatësi, peshë, ngjyrë të lëkurës dhe tipare të tjera. Nga prindërit marrim gjenet që janë përbërësi themelor i trashëgimisë, por edhe stilin e jetës, edukimin në familje, të cilat ndikojnë në shëndetin tonë. Nga prindërit ne gjithashtu trashëgojmë “ndryshimet” e lindura në gjene, të cilat mund të rrisin mundësinë e zhvillimit të sëmundjeve kongjenitale.

Modeli i trashëgimisë për disa sëmundje kongjenitale është i qartë për të tjerat është më i ndërlidhur. Ndjonjehëre mjafton ndryshimi i gjenit vetëm nga një prind për t'u zhvilluar një sëmundje. Për sëmundje të tjera, është e nevojshme që të dy prindërit të kenë ndryshim të gjenit të njëjtë, që fëmija të zhvillojë sëmundjen gjenetike. Sëmundja gjithashtu mund të transmetohet nga prindërit të cilët nuk e dinë se e mbartin sëmundjen. Ka të ngjarë që njérëzit të mbajnë 5 ose më shumë gjene të lidhura me një sëmundje pa qenë në dijeni për këtë.

Sëmundja mund të thuhet se "bartet nga brezi në brez" nese më shumë se një anëtar i familjes ka atë sëmundje. Disa çregullime që prekin më shumë anëtarë të familjes shkaktohen nga mutacionet gjenetike që transmetohen nga prindi tek fëmija. Disa sëmundje të tjera shkaktohen nga mutacionet në gjene të caktuara, të shkaktuara nga faktorët e mjedisit ose nga një kombinim kompleks i faktorëve gjenetikë dhe mjedisorë (ndotja, rrezatimi, dieta, stili i jetesës). Mutacioni gjenetik mund të ndodhë edhe për herë të parë, rastësish ose për shkak të disa faktoreve të mjedisit.

Historia familjare është e rendësishme, por edhe është një afërm me një sëmundje të caktuar nuk do të thotë se një person patjetër do ta zhvillojë atë sëmundje. Nga ana tjetër, një person pa ngarkesë familjare për një sëmundje të caktuar mund të ketë rrezik të zhvillimit të kësaj sëmundjeje për arsyte të tjera. Ndonjëherë nuk është e lehtë të përcaktohet nese çregullimi në familje është i lindur.

Kanceri është një sëmundje gjenetike, sepse përfshin gjenet në qelizë (duke shkaktuar që ajo të ndahet në mënyrë të pakontrolluar), por vetë kanceri mund të shkaktohet nga shkaqe të tjera dhe nuk është e nevojshme të trashëgohet nga prindërit. Në fakt, vetëm disa lloje të kancerit mbartin rrezik për të afërrit. Nëse babai, vellai, xhaxhai, daja ose gjyshi kanë pasur kancer të prostatës, ekzaminimet duhet të fillojnë më herët, pas moshës 40 vjeçare. Përkancerin e gjirit dhe kancerin e vezoreve, ekzaminimet e rregullta janë të rendësishme, veçanërisht nese nëna, motra, halla, tezja ose gjyshja, kanë pasur kancer në moshë më të re, para menopauzës. Përkancerin e zorrëve është e rendësishme të dihet se sa anëtarë të familjes kanë pasur tashmë kancer të zorrëve, në çfarë moshe, sa e afërt është lidhja farefisnore me ta.

Për sa u përket sëmundjeve kardiovaskulare, sëmundjeve të zemrës dhe goditjes në tru, ka shumë faktore tek të cilët mund të ndikohet, edhe atë pirja e duhanit, pasiviteti, ushqimi i pashëndetshëm, mbipesha e kështu me radhë.

Dikush mund të "trashëgojë" predispozitat ndaj presionit të lartë të gjakut dhe kolesterolit të lartë.

Kur është fjala për diabetin, dihet se stili i jetës luan rol të madh, kurse ndryshimi i hershëm i zakoneve

mund të ndikojë shumë në shfaqjen e diabetit, rregullimin e tij dhe shfaqjen e komplikimeve.

Shëndeti i syve, katarakti, glaukoma, degjenerimi makular janë shkaqet kryesore të humbjes së shkimit. Nëse të dy prindërit vuajnë nga shkurt-pamësia, ka 50% të ngjarë që edhe fëmija të jetë shkurt-pamës, nese vetëm një prind është shkurt-pamës, rreziku zvogëlohet në 10%. Besohet se edhe astigmatizmi dhe daltonizmi trashëgohen ndër familje.

Pirja ndaj problemeve menstruale, si menstruacionet e dhimbshme, endometrioza ose vezoret policistike gjithashtu është e trashëgueshme.

Kariesi paraqitet nën ndikimin e baktereve, por pirja ndaj kariesit, cilësia e dhëmbëve, sëmundjet e dhëmbëve, pirja ndaj problemeve me dhëmbët trashëgohen nga prindërit.

Gjenetika fajësohet për shfaqjen e problemeve të shumta shëndetësore, por çfarë në të vërtetë trashëgohen janë predispozitat ndaj tyre. Nëse prindërit ose gjyshërit kanë pasur alergji ose astmë, ka të ngjarë që pasardhësit të kenë probleme të ngjashme. Në 60% të rasteve, predispozita ndaj alergjive trashëgohen nese të dy prindërit kanë një alergji të caktuar, nese ka vetëm një prind, rreziku zvogëlohet në 40%. Nëse ka dikush me alergji në familje, probabiliteti i trashëgimisë së ekzemës atopike dhe psoriazës është i lartë. Nëse një prind ka astmë, shanset që fëmija do të zhvillojë astmë janë rreth 25%.

Deri kohët e fundit, është sugjeruar se gjenet që trashëgohen nga prindërit kodojnë sëmundjen dhe janë mënyra më e zakonshme e rrezikut të trashëguar për sëmundjet. Por, në përgjithësi, rreziku i zhvillimit të një sëmundjeje të caktuar varet nga më shumë faktore, ndërsa pjesa që trashëgohen nga familja është vetëm një copë e enigmës. Tanimë është ardhur në përfundimin se ADN-ja nuk përcakton fatin tonë shëndetshor më vete dhe si rrjedhojë, shkenca është fokusuar në një nivel tjetër të trashëgimisë së potencialit gjenetik, të quajtur epigenetikë. Epigenetika shpjegon se nuk përcaktohem (vetëm) nga gjenet dhe hulumton ndikimin e faktoreve të tjera. Kjo do të thotë që ne kemi aftësinë për të kontrolluar shprehjen e gjeneve, për të kontrolluar deri në çfarë mase "trashëgojmë" një

gjendje të caktuar shëndetësore.

Ndryshimet epigenetike mund të ndodhin nga ekspozimi ndaj faktorëve si pirja e duhanit, rrezatimi, kimikatet, të ushqyerit etj. Mjedisit ynë ka aftësinë për të "aktivizuar" ose "çaktivizuar" gjenet që lidhen me sëmundjen. Ndryshimet ndikojnë në mënyrën se si qelizat "lexojne" gjenet. Kjo do të thotë se çdo gjë ndikon në modelin tonë gjenetik. Trupi, mendja, shpirti dhe gjenet na bëjnë ata që jemi.

Sot po lëvizim nga një gjendje e "robërise", "përfuzimit" nga gjenet tonë në një gjendje ku kemi fuqinë të ndryshojmë shprehjen e gjeneve. Fuqia është në duart tona, jetesa jonë ka fuqinë për të ndikuar te gjenet. Sipas teorisë gjenetike të plakjes, jetëgjatësia përcaktohet edhe nga gjenet tonë. Studiues të tjere besojnë se vetëm 25% e jetëgjatësia sonë përcaktohet nga faktorët e trashëguar dhe se ndikim shumë më të madh kanë faktorët e jetesës (alkool, pirja e duhanit, stërvitja, të ushqyerit).

Besohet se epigenetika merr pjesë në zhvillimin e disa kancereve. Për shembull, një ndryshim epigenetik që "hesht" gjenin që mban rritjen e qelizave nën kontroll çon në rritjen e pakontrolluar të qelizave të tumorit. Nët tjetër ndryshim epigenetik "përashton" gjenet që riparojnë ADN-në e dëmtuar, me çka rritet dëmtimi i ADN-së dhe rreziku i kancerit.

Duke ditur historinë familjare të shëndetit, mund të ndërmerrni hapa për të zvogëluar rrezikun, si fillimi më i hershëm i ekzaminimeve parandalues (mamografia, kolonoskopja). Ndryshimet e jetesës, si përvetësimi i një diete të shëndetshme, ndërprerja e pirojeve së duhanit, aktiviteti i rregullt fizik, zvogëlimi i konsumit të alkoolit mund të ulin shanset për zhvillimin e shumë sëmundjeve.



Dr. Med. Sci. Maja Milovančeva-Popovska  
Internist-Nefrolog  
IPSH PROMEDIKA MEDIKAL CENTAR

# Përfitimet e

# SUMAKUT



Me ndihmën e një diete të shëndetshme, është e mundur të forcohet sistemi imunitar dhe të parandalohet shfaqja e llojeve të caktuara të sëmundjeve. Në planin tuaj të ushqimit, përpinqi të përfshimi sa më shumë ushqime të pasura me antioksidantë, vitamina dhe minerale ose bimë të dobishme nga të cilat do të keni shumë përfitime shëndetësore.

Një nga përbërësit e pasur me përfitime për organizmin tonë është sumaku, i cili shpesh përdoret në gatim, veçanërisht në rajonet lindore dhe juglindore. Këshillohet përfshirja e këtij përbërësi të dobishëm dhe ushqyes në dietën tonë të përditshme për të gjuar shëndet të mirë.

Sumaku është një lloj erëze që fitohet nga bima e quajtur Rus, e cila shpesh quhet "pema e sumakut". Frutat e kësaj bime kanë një shije të thartë, ndërsa në dukje përngjan si shkurre. Sumaku merret nëpërmjet tharjes, me ndihmën e teknikave të përshtatshme pasi të mblidhet nga pema. Më shpesh përzihet me kripën dhe përdoret si pluhur, në formë të erëzës. Në kultura të caktuara, sidomos në shtetet lindore, shpesh përdoret në lloje të ndryshme të sallatave, veçanërisht në ato ku nevojitet të zvogëlohet era e qepës.

Për shkak të veprimit të saj anti-inflamator dhe antioksidues, kjo erëz e shëndetshme sjell një numër të madh përftimesh për organizmin e njeriut.

## Cilat janë përfitimet që sjell sumaku?

Sumaku është një bar shumë i çmueshëm me përfitime të pafundme. Një nga arsyet më të rëndësishme për këtë është vetia shumë e fortë antioksiduese që e dallon. Aspekti i dytë pozitiv është se ka përbajtje të lartë të vitaminave dhe minraleve. Ja përfitimet nga përdorimi i sumakut për shëndetin e njeriut:

## Një antioksidant i rëndësishëm

Sumaku është një antioksidant shumë më i fuqishëm se shumë lloje të erëzave që njihen prej shumë kohësh dhe që janë përdorur gjierësisht për vëtitë e tyre antioksiduese. Ai zvogëlon radikalet e lira që qarkullojnë në trup dhe ul nivelin e stresit oksidativ. Falë këtij efekti pozitiv që shkakton, parandalon qelizat të bëhen kancerogjene dhe siguron një efekt mbrojtës kundër të gjitha llojeve të kancereve. Përveç kësaj, në sajë të veprimit të tij antioksidues, zvogëlon ndjeshëm mundësinë e shfaqjes së shumë sëmundjeve kronike, veçanërisht sëmundjeve kardiovaskulare.

**SUMAKU ËSHTË  
NJË BAR SHUMË  
I ÇMUESHËM ME  
PËRFITIME TË  
PAFUNDME**



## Ka veti anti-inflamatore

Për shkak të veticë anti-inflamatore, sumaku rrit fuqinë për të luftuar sëmundjet infektive që mund të vërehen në organizëm, në veçanti gripin dhe ftohjet. Ndihamon në uljen e eteve dhe kapërcimin e sëmundjeve ngjithëse. Meqenëse është i mbushur me vitaminë C, sumaku forcon imunitetin.

## Rregullon sheqerin në gjak

Disa studime shkencore tregojnë se përdorimi i rregullt i sumakut ofron mbrojtje kundër shumë sëmundjeve kronike dhe mbështet shërimin. Njëra prej tyre është diabeti. Studimet tregojnë se sumaku ndihmon në rregullimin e niveleve të sheqerit në gjak dhe gjithashtu mbështet zvogëlimin e problemeve të shkaktuara nga diabeti i tipit 2, duke mbështetur rënien e nivelit të kolesterolit në gjak. Shumë ndërlidhje të vërejtura te pacientët me diabet të tipit 2 ndodhin si rezultat i nivelit të lartë të sheqerit në gjak për një kohë të gjatë.

## Mbron nga infekzionet

Për shkak të efekteve antibakteriale, sumaku është i njojur si ndihmës në zbutjen e infeksioneve të shkaktuara nga mikroorganizmat, si *Salmonella Tifimurium* dhe *Aspergillus Flavus* dhe mënjanon ndërlidhjet e shkaktuara nga këto infeksione. Për më tepër, marrja e sumakut në formën e çajit, zvogëlon dhimbjen e fytit në sëmundjet infektive të traktit të frymëmarries, sidomos në zonën e fytit, ndihmon në parandalimin e simptomave si dhimbja e fytit dhe kolla, të shkaktuara nga sëmundja.

## Ka efekt diuretik

Sumaku është një diuretik i fuqishëm. Falë këtij efekti, sumaku ndihmon për të mbrojtur kundër infeksioneve të traktit urinar, duke ulur presionin e lartë të gjakut.

## Mbron nga sëmundjet e arteries koronare

Sumaku ndihmon në parandalimin e sëmundjeve të arteries koronare duke ndihmuar në uljen e niveleve të kolesterolit dhe triglicerideve në gjak. Në të njëjtën kohë, është shumë efektiv në parandalimin e sëmundjeve kardiovaskulare për shkak të efekteve të tij pozitive në shëndetin e enëve të gjakut dhe rregullimin e qarkullimit të gjakut.

## Është i rëndësishëm për shëndetin e grave

Studimet tregojnë se konsumimi i sumakut zvogëlon dhimbjen menstruale tek gratë. Gratë që përjetojnë dhimbje të mëdha menstruale duhet të konsumojnë sumakun si erëz, si çaj ose ta shtojnë në kos. Përveç kësaj, dihet se përdorimi i sumakut në dietën e nënave që ushqejnë me gji ka ndikim dobiprurës në qumështin e nënës.

## Si të konsumoni sumakun?

Sumaku është një lloj erëze e cila gjen përdorim të shkëlqyer në sallatë. Përveç kësaj, lëngu i sumakut mund të përdoret edhe në ushqime, ku mund të japë një shije të thartë. Çaji i sumakut është gjithashtu një opsjon shumë i dobishëm, sidomos për njerëzit me faringjitet kronik, ndezje të fytit ose kollë të thatë. Për të përgatitur çaj sumaku, mund të shtoni një lugë sumak në një gotë me ujë dhe ta vloni atë për 5 minuta. Para se të vendosni për përdorimin e rregullt të kësaj erëze, konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj për sasinë e saktë.

живеј здраво, живеј сега



Тримекс

КУПУВАЈ ONLINE НА [WWW.TRIMOKS.COM.MK](http://www.trimoks.com.mk)

ул. Владимир Пологиновски бр. 9, Скопје  
02 32 46 000  
[info@trimoks.com.mk](mailto:info@trimoks.com.mk)  
[www.facebook.com/Trimoks](https://www.facebook.com/Trimoks)





# USHQIMI GJATË PANDEMISË ME COVID-19

Ushqimi i drejtë është i domosdoshëm për të ruajtur shëndetin e mirë, veçanërisht në luftën kundër virusave, ku ruajtja dhe stimulimi i funksionit të sistemit imunitar është tejet i rëndësishëm. Edhe pse funksioni i tij përcaktohet nga gjenetika, ndikim të madh kanë ndër të tjera edhe të ushqyerit, stresi, aktiviteti fizik dhe gjumi.

Faktor veçanërisht i rëndësishëm është dieta, sepse ushqimet përbajnjë vitamina, minerale dhe përbërës të tjera, të cilët janë stimulues të funksioneve mbrojtëse të trupit dhe rrisin rezistencën ndaj infeksioneve të ndryshme virale dhe bakteriale, si dhe rritjes së kancerit, i cili varësishet nga mekanizmat e sistemit imunitar mund të përparojë ose të tertiqet.

Duhet të jemi posaçërisht të kujdeshëm me përdorimin e ushqimeve të përpunuara që përbajnjë shumë yndyrna, aditive, sheqer dhe kripë. Vëmendje duhet t'i kushtohet edhe madhësisë dhe densitetit të vakteve. Gjegjësish, në vaktet kryesore gjysma e pjatës duhet të jetë perime, një e katërtë burime të proteinave (mishi i bardhë, i gjeldetit ose pulës, peshku, vezët, produktet e qumështit, pa yndyrë dhe të fermentuara) dhe një e katërtë burime të karbohydrateve (bishtajore, patate, drithëra integrale). Për mesvakte, merrni një copë frut të mesëm ose një grusht arra (arra, shqeme, bajame, lajthi), por jo më shumë se 50 gram.

Duhet të kufizohet marja e kripës dhe sheqerit. Ushqimi i përpunuuar dhe i konservuar përmban shumë kripë, ndaj në vend të biskotave, karamaleve dhe ëmbëlsirave, ëmbëlsuhuni me fruta të freskët apo të ngrirë ose lëng frutash. Për të zgjögulluar densitetin e vakteve është më mirë të rritet sasia e perimeve në vakte. Nëpërmjet perimeve dhe frutave ju do të merrni sasi të mjaftueshme të vitaminave, mineraleve dhe fibrave.

Përgatitni ushqimin me vajra të shtrydhur në të ftotë (mos i ngrohni në temperaturë të lartë), konsumoni yndyrna të shëndetshme përmes peshkut, vajit të ullirit, arrave, avokados, si dhe kufizoni ngrënien e mishit të kuq, qumështit dhe produkteve të qumështit me yndyrë të plotë.

Për funksionimin e duhur të traktit gastrointestinal ju nevojiten fibra, të cilat mund t'i merrni përmes elbit, melit, fasuleve, bizeleve,

thjerrëzave, qiqrave dhe t'a bashkëngjitet vaktit kryesor.

Për hidratim të mjaftueshëm, pini çaj të paëmbëlsuar, ujë dhe supa. Kufizoni marrjen e lëngjeve të gazuara dhe artificiale dhe alkoolit, ngase ky i fundit mund të ndryshojet aftësitet psikofizike, të ndikojë negativisht në imunitet, si dhe të shtojë simptomat e depresionit, ankthit, frikës dhe panikut.

Në rreshtin e parë të betejës kundër infeksioneve, edhe gjatë pandemisë me Covid-19, janë qelizat e bardha të gjakut, funksioni i të cilave ndikohet shumë nga ushqimi që konsumojmë. Ky grup përfshin neutrofilet (të cilat sulmojnë bakteret), limfocitet që ndahen më tej në qelizat T, qelizat B dhe qelizat NK. Qelizat B prodhojnë antitrupa që shkatërrojnë viruset dhe bakteret, qelizat T menaxhojnë shumë aktivitete imunologjike dhe prodhojnë dy substancë, interferonin dhe interleukinën, që luajnë rol të madh në luftën kundër infeksioneve, ndërsa qelizat NK konsiderohen si mbrojtja e parë e organizimit, domethënë shkatërrojnë qelizat e prekura nga virusi.

Shumë studime tregojnë se ushqime dhe përbërës të ndryshëm të ushqimit rregullojnë përqendrimin e qelizave të bardha të gjakut në gjak, domethënë ekzistojnë një sërë të dhënash që tregojnë se ushqimi mund të stimulojë punën e sistemit imunitar dhe të përmirësojë veprimin e tij.

Ato janë ushqimet të cilat duhet të janë në qendër të vëmendjes dhe më shpesht të përfaqësohen në dietë, me qëllim që të përmirësohet puna e sistemit imunitar:

- Kosi, sidomos ai që përmban kultura të gjalla dhe aktive bakteriale, mund të stimulojë krijin e interferonit gama, që vepron kundër infeksioneve, të përmirësojë veprimin e qelizave NK dhe të rrisë prodhimin e antitrupave.

- Kërpudhat shiitake përbajnjë substancë antivirale lentinan që modulon përgjigjen imunologjike duke stimuluar aktivitetin e makrofagëve dhe limfociteve T. I njëjti veprim kryhet edhe nga përdorimi më i shpeshtë i hudhavave.

- Kërpudha reishi është përdorur për mijëra vite në mjekësinë tradicionale kinezë si një imunomodulator. Përmban më shumë se 400 komponentë bioaktivë që kanë veti anti-inflamatore, antibakteriale,

antivirale dhe antioksiduese. Një numër i madh metodash enzimatike identifikojnë disa komponentë triterpenoide të kësaj kërpudhe që pengojnë enzimat si proteaza ose neuraminidaza, të cilat u nevojiten viruseve për të prodhuar grimca infektive ose për të infektuar qelizat.

- Përdorimi më i shpeshtë i frutave dhe perimeve që përbajnjë beta karoten, sidomos spinaqi, karota, kungulli, patatja e ëmbël, lakra jeshile, rrit numrin e qelizave specifike imune për të luftuar infekzionet.
- Zinku luan një rol të rëndësishëm në shumë funksione imunologjike. Është veçanërisht i rëndësishëm për njerëzit e moshës së shkuan, sepse me plakjen e gjëndrës së timusit, e cila luan një rol të madh në përgjigjen imunologjike, niveli i tij zvogëlohet dhe në këtë mënyrë zvogëlohet sekretimi i hormonit timulinë, i cili stimulon formimin e qelizave T.
- Marrja e sasive të vogla të verës mund të shkatërrojë dhe të asgjësojë organizmat që shkaktojnë sëmundje. Një komponent veçanërisht i rëndësishëm i verës së kuqe është resveratroli, i cili është një antioksidant shumë i fortë.
- Përdomi propolis, sepse lidhet me receptorët ACE-2 të cilët janë gjithashtu të rëndësishëm për virusin SARS-COV-2 dhe janë porta kryesore për hyrje në qelizë.
- Përdorimi më i shpeshtë i ushqimit djegës (hudhra, qepë, rrikë) hollon mukozën dhe vepron në mënyrë mukokinetike.

- Konsumimi më i madh i yndyrës ndikon negativisht në sistemin imunitar, sidomos yndyrnat poli-të-pangopura (Omega 6), të cilat janë më të përfaqësuar te vajrat e misrit dhe lulediellit. Këto acide yndyrore oksidohen më shpejt dhe kështu krijojnë radikale të lira që sulmojnë qelizat e sistemit imunitar.

Për imunitet më të fortë, përveç dietës së shëndetshme, kohëve të fundit është rritur përdorimi i shtojcave dietike, me theks më të madh te zinku, seleni, vitamina C, kercetina, vitamina D3, N-acetilcisteina, melatonina etj. Marrja e preparateve të tillë të izoluara është mire të kryhet nën mbikëqyrjen e një eksperti, pasi dozat më të mëdha të vitaminave ose mineraleve të ndryshme veprojnë si koenzima dhe forma e lire ose e palidhur e tyre mund të ketë efekt toksik në trup. Prandaj, më shpesh konsumoni ushqime që përbajnjë në formë natyrale komponentët e mësipërm, kurse atë që nuk mund ta merrni përmes dietës ose keni nevojë për doza më të larta, merreni në formën e shtojcave dietike.



dr. Dragica Zendelovska  
ONE HOSPITAL

BASHKËPUNËTORE E JASHTME NË FUSHËN E NUTRIGJENOMISË

## TRE BURIMET MË TË MËDHA NATYRORE TË LËNDËVE TË NDRYSHME USHQYESE

Lënda ushqyese	Ushqimet	Sasia per 100 g
Zinku	Mëlcia e vicit	6-8 mg
	Thjerrëzat	5 mg
	Gruri integral	4 mg
Seleni	Harenga, peshku ton	130-140 µg
	Sardelet	85 µg
Vitamina D	Gruri integral	55 µg
	Salmoni	16 µg
	Vezë të madhësishë mesatare	1 µg
Vitamina C	Mëlcia e vicit	1 µg
	Brokoli, lulëlakra	115 mg
	Luleshtrydhët	65 mg
Kercetina	Grejfruti (1/2 madhësi të mesme)	60 mg
	Qepët	22 mg
	Kakaaja	20 mg
	Boronica dhe specat djegës	14 mg



# HOROSKOP JANAR



DASHI 21.03-20.04

Ndryshimi më i mirë që mund ta bëni për të përmirësuar shëndetin, do të jetë nisja e një diete krejtësisht të re. Mos bëni ndryshime të menjëherësme, por filloni dalëngadalë. Rritni sasinë ditorë të lëngjeve, pastaj dalëngadalë zvogëloni sasinë e ushqimit të shpejtë. Mundohuni gjithashtu të ulni sasinë e kafeinës dhe të përpinqenit të zëvendësoni kafen me çaj. Shumë shpejt do të vëreni një ndryshim tepër të mirëseardhur në trupin tuaj!



GAFORRA 21.06-20.07

Yjet parashikojnë një periudhë në të cilën do të keni shëndet tё mirë dhe pa ndonjë shqetësim serioz. Do të kaloni një periudhë që do t'ju bëje të ndjeni se po riteni dhe pikenit për gjérat tё cilave nuk u keni kushtuar shumë vëmendje më parë. Nëse keni sëmundje kronike, mos anashkaloni kontrolllet e rregullta me mjekun tuaj. Drejtoni energjinë tek gjérat që ju bëjnë të lumtur.



PESHORJA 23.09-22.10

Ndiqni me kujdes shenjat që juaj dërgon trupi dhe ndryshoni disa nga zakonet tuaja tё përditshme që mund t'ju dëmtojnë. Nëse ju duhet motivim për të filluar një dietë tё caktuar ose ndonjë lloj aktiviteti sportiv, kërkoni ndihmë ose shoqëri nga miqtë tuaj. Fillimi i vitit është një mundësi e shkëlqyer për tё përcaktuar një qëllim sipas të cilit do tё përaparoni duke ndjekur disa parime.



BRICJAPI 21.12-19.01

Energjia planetare do ta bëjë mendjen tuaj tё shpejtë edhe më tё vëmendshme. Ndoshta është koha tё shikoni se gjérat e vogla që i quani tё parëndësishme, ndikojnë shumë më tepër në disponimin tuaj. Vendasni baraspeshën midis familjes dhe profesionit, sepse në të ardhmen e afërt ju pret një periudhë tё vështirë gjatë së cilës do tё duhet tё përcaktoni përparsësitë tuaja.



DEMI 21.04-20.05

Ju pret një periudhë ku mbështetja nga të afermit do tё jetë çelësi për tejkalinin e vështirësive profesionale me të cilat përballeni. Kujdesuni për shëndetin dhe përpinquni tё bëni gjumë cilësor. Motivoni veten me mendimin se të gjitha shqetësimet me të cilat përballemi në jetë janë tё përkohshme dhe se shëndeti duhet tё jetë në radhë tё parë.



LUANI 21.07-21.08

Do tё habiteni se sa energjik do tё ndiheni në fillim tё muajit. Ju pret një muaj me shëndet tё mirë, përvèç problemeve tё vogla me sistemin e tretjes. Kujdesuni për sasinë e ushqimit që konsumoni këtë periudhë dhe përpinquni tё qëndroni në formë. Luanët që rregullisht merren me sport do tё ndjejnë një dëshirë edhe më tё madhe për tё përbushur aktivitetet e tyre me praktika tё reja.



AKREP 23.10-22.11

Fuqia e gjykit tё shëndoshë ngadhënen kur çlironi energjinë e tepërt duke ushtruar ose praktikuar ndonjë lloj aktiviteti sportiv. Të gjitha emocionet sipërfaqësore që shfaqen si pasojë e stresit tё madh, si trishtimi apo zemërimi, kanë nevojë tё çlironen rregullisht. Gjeni mënyrën për tё zëvendësuar energjinë e keqe me mendime pozitive dhe hare.



UJORI 20.01-18.02

Ju pret një periudhë në tё cilën do tё keni shëndet tё brishtë. Përdomi instinktet tuaja dhe zgjidhni ushqimin e duhur për trupin tuaj. Duhet tё shmanget ushqimi i rritur me hormone, pasi ato stimulojnë prodhimin e tepërt tё estrogenit dhe testosteronit te gratë, përkatësisht te burrat. Jini tё vëtedjishëm për ushqimet që hani dhe ushqeni veten me zgjedhje tё shëndetshëm.



BINJAKËT 21.05-20.06

Për shkak tё stresit që po përjetoni kohëve tё fundit, ju pret një periudhë gjatë së cilës do tё ndjeni ca ndryshime tё vogla në trupin tuaj, si dhe kokëdhimbje tё shpeshta. Kini kujdes nga ftohjet sezionale që janë tё zakonshme gjatë kësaj periudhe, veçanërisht te njerëzit me imunitet tё dobët. Merrni dozenë e nevojshme ditorë tё vitaminave dhe mineraleve dhe përpinquni tё zvogëloni sa më shumë nivelin e stresit.



Kujdes nga lëndimet fizike gjatë kësaj periudhe. Për shkak tё periudhës së vështirë që e keni lënë mbrapa, do tё keni vështirës gjatë përqendrimit në punën tuaj, prandaj keni nevojë për një pushim që do t'ju rikthejë energjinë e mëparshme. Mos e teproni me marrien e shegerit në organizëm.



VIRGJERËSHA 22.08-22.09



HNetët pa gjumë dhe lodhja që keni ndjerë kohëve tё fundit është rezultat i shqetësimeve tё panevojshme që ju krijojnë një barrë tё madhe. Pjesët e ndjeshme në trupin tuaj këtë muaj do tё jenë fyti, qafa dhe gjëndra tiroide, kështu që nëse ndjeni ndonjë ndryshim, konsultohuni me mjekun. Ndryshoni pozicionin e uljes para kompjuterit nëse ju krijon një ndjenjë tё pakëndshme në shpinë.



SHIGJETARI 23.11-20.12

Shëndeti juaj mund tё jetë i mirë për momentin dhe nuk ka asnjë arsy për tё kërkuar ekzamim të mjekësor. Por ndoshta vuani nga dhimbja në shpinë dhe në qafë për shkak tё shoqërimit tё tepër me miqtë. Ushtronit dhe meditonit. Hani ushqim Satvik. Kjo mund t'ju mbajë tё shëndetshëm.



PESHQIT 19.02-20.03

# PARODONTOPATIA



spec. dr. Natasha Naumoska  
specialiste për protetikë dentare  
IPSH "IN DENT" - SHKUP

Parodontopatia ode parodonta e shtetë e sëmundje së kronike inflamatore e aparatit mbështetës të dhëmbëve apo pjesës së indeve që mbulojnë dhëmbin dhe i jepin qëndrueshmëri dhe stabilitet. Kjo sëmundje çon në shkatërrim të thellë të indit parodontal të dhëmbëve, çka përfundon me humbjen e dhëmbëve. Sëmundja mund të shfaqet në çdo moshë, duke filluar nga fëmijëria e hershme (parodontopatia agresive) deri në moshën e mesme dhe më të pjekur (parodontopatia kronike). Faktorët kryesorë që ndikojnë në shfaqjen e kësaj sëmundjeje janë mikroorganizmat nga plaka dentare dhe produktet e tyre. Përveç pranisë së mikroorganizmave, higjiena e dobët e gojës, pirja e duhanit, protezat e punuara në mënyrë joadekuate, si dhe disa sëmundje të organizmit po ashtu mund të ndikojnë në shfaqjen e parodontopatisë. Kjo sëmundje fillon me inflacion të mishit të dhëmbëve (gingivit) dhe nëse nuk trajtohet me kohë, kalon në parodontopati, prek kockën përreth dhëmbëve dhe mund të sjellë lëkundje, zhvendosje dhe përfundimisht rënien e dhëmbëve.

Qëllimi kryesor në trajtimin e parodontopatisë është eliminimi i mikroorganizmave patogjene nga xhepat parodontale, heqja e depozitave nën dhe mbi mishrat nga dhëmbët. Format më të lehta, si inflamacioni i gingivës, mund të shërohen duke hequr depozitat, duke pastruar gurin e dhëmbëve dhe duke edukuar pacientin për ruajtjen e duhur të higjenës orale, me çka do të pengohej shfaqja e sërishtme.

Trajtimi i parodontopatisë varet nga fazë në të cilën ndodhet sëmundja. Përveç trajimit konservativ, në disa raste lind nevoja edhe përfshirje të terapisë me antibiotikë dhe terapisë me laser. Në rastet më të rënda të parodontopatisë, kërkohet edhe ndërhyrje kirurgjikale, përfshirje të kockës artificiale, me qëllim të ripërtërirjes së indeve parodontale dhe indeve të kockave.

Parodontopatia po kthehet në sëmundje të kohëve moderne, me një përhapje të madhe në mesin e popullatës, si në vendin tonë ashtu edhe në nivel global.

Prandaj, nëse vini re gjakderdhje të shpeshta nga mishrat gjatë larjes së dhëmbëve, zhvendosje të dhëmbëve gjatë viteve (përparrë, në gjersë), dhimbje të papërcaktuara dhe të vazhdueshme në zonën e të gjithë dhëmbëve, lëkundje ose hapësirë midis dhëmbëve, është koha përfshirje të caktuar një vizitë te dentisti!



## SolDevit<sup>®</sup> 1000

Витамин Д<sub>3</sub> (холекалциферол)

Содржи витамин Д<sub>3</sub> кој придонесува за:

- нормално одржување на коски и заби
- нормална функција на мускулите
- нормална функција на имунолошкиот систем



ЛЕСНО ДО СВОЈАТА  
ДНЕВНА ДОЗА на Витамин Д |

PHARMANOVA

[www.pharmanova.mk](http://www.pharmanova.mk)

Пред употреба внимателно да се прочита упатството. За индикациите, ризикот од употреба и несаканите дејства на лекот консултирајте се со вашиот лекар или фармацевт.



## MANASTIRI

Barnatore Viola  
047-222-235  
Barnatore Neo Farm  
047-224-301  
Barnatore Farm-Zdravje  
047-223-039  
Barnatore Farm-Zdravje 2  
047-242-039

## Demir Hisar

Barnatore Dehi Farm  
047-276-644

## GJEVGJELIA

Barnatore Nima  
034-214-562

## GOSTIVARI

Barnatore Botanik  
042-211-413

Barnatore Diti Farm  
042-212-164

Barnatore Mikrofarm  
042-371-622

Barnatore Pro-Farm  
042-213-132

Barnatore Vivalek 4  
042 313496

Barnatore Diti Farm 3  
042-622-888

## GOSTIVAR F. ČEGRANE

Barnatore Med-Farm  
042-321-363

## GOSTIVAR F. DOBRI DOL

Barnatore Genius-Farm  
042-311-229

## GRADEC

Barnatore Albi Farm  
071-822-270

## KAVADAR

Barnatore Farmakon-Lek  
043-411-891

Barnatore Farmanea  
043-550-900

## KERÇOVA

Barnatore Herba 1  
045-223-978

Barnatore Herba 2  
045-261-265

Barnatore Blina  
045-222-550

## KOÇANI

Barnatore Fitomed  
033-273-805

Barnatore Higija Farm  
033-271-522

## KR PALLANKA

Barnatore Qytet Kr. Pallanka  
031-375-012

## KRIVOGASHTANI

Barnatore Menta Farm 4  
048-471-987

## KUMANOVË

Barnatore Adonis  
031-411-098

Barnatore Dafina  
031-413-977

Barnatore Isidora  
031-550-635

Barnatore Kamilica  
031-550-603

Barnatore Novalek  
031-422-111

Barnatore Farmalek  
031-416-503

Barnatore Filiz  
031-416-700

Barnatore Kaiser Farm  
078/452-702

Barnatore Zani Farm  
031-445-434  
**NEGOTINA**

Barnatore Negotino  
043-361-433

Barnatore Negotino 1

## NOVO SELLË

Barnatore Zdravje  
034-522-279

## OHËR

Barnatore Bio-Lek  
046-260-580

Barnatore Kavaj  
046-260-940

Barnatore Pasholi  
046-255-070

Barnatore Planta  
046-250-533

Barnatore Heledona  
046-257-744

## PRILEP

Barnatore 2005 VIVA FARM  
048-400-901

Barnatore Biolek  
048-416-208

Barnatore Karakash 1  
048-414-722

Barnatore Menta Farm1  
048-422-551

Barnatore Ortofarm  
048-436-100

## PROBISHTIP

Barnatore Ema Farm  
032-482-666

## RADOVISH

Barnatore Filip Vtorni  
071-945-549

## RESNJË

Barnatore Sigia-Farm Resnje  
047-454-360

Barnatore Farma-Lek-2005  
047-452-553

## F. DOLLNO PALÇISHTE

Barnatore Losiones Medika  
044-391-025

## SHKUP

Barnatore Aloe  
02-2039-915

Barnatore Ambrozija Farm  
02-3224-399

Barnatore Andra Lek  
02-3225-422

Barnatore Vivalek 1  
02-2617-740

Barnatore Vivalek 2  
02-2562-222

Barnatore Vivalek 3 Creshevo  
02-2573-953

Barnatore GoldMun 2  
02-2616-338

Barnatore GoldMun3  
02-2635-555

Barnatore GoldMun 5  
02-2431-600

Barnatore GoldMun7  
070-269-866

Barnatore Da-Jana-Farm  
02-2655-500

Barnatore Datel Farma  
02-2612-536

Barnatore DNA ANNI FARM 3  
02-2445-935

Barnatore Jasmin  
02-2794-349

Barnatore LAJFLAJN  
02-3075-576

Barnatore Lincura  
02-2434-600

Barnatore Mak Farm  
02-3071-289

Barnatore Makmedika  
02-2031-082

Barnatore Nela Farm  
02-2477-900

Barnatore Nika Farm  
02-2572-801

Barnatore Nika Farm 1  
02-2545-111

Barnatore Omega Farm 1  
02-3125-202

Barnatore OmegaFarm 3  
02-3114-086

Barnatore Opium  
02-2440-335

Barnatore Oskar lek  
02-3132-227

Barnatore PavloFarm  
02-2467-589

Barnatore Polin  
02-2432-002

Barnatore Regina  
02-2622-205

Barnatore Sara Farm 1  
02-2792-880

Barnatore Sara Farm 3  
02-3220-049

Barnatore Sara Farm 4  
02-3113-129

Barnatore Saraj Farm  
02-2057-069

Barnatore Stem  
02-3176-335

Barnatore Datel Farma Qendër  
075-265-564

## SHTIP

Barnatore Biolek  
032-391-777

Barnatore Dijana  
032-392-707

Barnatore Zdravje 1  
078 264 148

Barnatore Zdravje 2  
078 264 141

Barnatore Medifarm  
032-394-143

Barnatore Radolek  
032-380-190

## STRUGA

Barnatore Beladona  
046-786-750

Barnatore Hamamelis  
046-702-706

## STRUGA F.VRANISHTA

Barnatore Hamamelis 2  
046-702-706

## STRUMICA

Barnatore Verbena  
034-551-031

Barnatore Zanina  
034-346-972

Barnatore Zanina 2  
079-273-700

Barnatore Panacea  
034-320-395

Barnatore Farmaka  
034-322-251

Barnatore Verbena 2  
034-550-519

## TETOVË

Barnatore Bami Kor Medika  
044 335 747

Barnatore Qytet Tetove  
044-334-425

Barnatore Eliskir  
070-887-393

Barnatore Herba  
044-335-145

Barnatore Andol-G  
044-347-049

Barnatore Biofarm  
044-344-292

Barnatore Vital-Farm  
071-536-614

Barnatore Dushica Farm  
044-451-002

Barnatore Medika  
044-339-466

Barnatore Losiones Medika Farm 1

## TETOVË F. PIROK

Barnatore Sano Farm  
044-371-579

## TETOVË F. TEARCË

Barnatore Herba Farm 2  
071-224-827

## TETOVË F. VRATNICË

Barnatore Mena Farm  
078-415-079

## VEVÇAN

Barnatore Beladona  
070-362-210

## VELES

Barnatore Ziva Farm 1  
043-235-121

Barnatore Ziva Farm 2  
043-251-005

Barnatore Ziva Farm 3  
043-230-121

Barnatore Ziva Farm 4  
043-225-255

Barnatore Ziva Farm 5  
078-371-585

Barnatore Magna Farm 2  
043-211-499

## VINICA

Barnatore Arka  
033-362-685

Barnatore Arka Nova  
033-364-685

Заштитен крем за бебиња

**Sudocrem®**

[www.sudocrem.com](http://www.sudocrem.com)

**Сојузник  
на мајките  
повеќе од 80  
години**



практично  
пакување од  
**60g**

Поголемо  
економично  
пакување од  
**125g**

**Смирува • Негува • Штити**

Посебниот хипоалергенски состав ја штити и смирува  
црвената и оштетена кожа, вклучително и пеленската регија  
и другите места со испукана и надразната кожа

**PLIVA**

[www.pliva.com](http://www.pliva.com)

[www.plivazdravlje.hr](http://www.plivazdravlje.hr)


ПЛИВА ДООЕЛ Скопје  
Никола Парапунов б.б. Скопје  
тел./факс +389 2 3062702

MK/SUD/18/0003



# LIVSANE

## LIVSANE Ампули за зголемување на имуниот систем



Viamedi Healthcare GmbH, Deutschland



Европа Лек Фарма ДООЕЛ, Скопје, Р. Македонија

**Пред употреба внимателно да се прочита упатството! За индикациите, ризикот од употребата и несаканите дејства на граничниот производ консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.**